



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 200

Tiranë – E hënë, 16 nëntor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11809, datë 4.11.2020	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 14237
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 866, datë 11.11.2020	Për dhënien me qira, me tarifë të reduktuar, të sallës ovale “B” dhe të zyrave me numra 2/1, 3, 3/1, 6, 7 e 11, në ambientet e Pallatit të Kongreseve, Komisionit të Prokurimit Publik..... 14237
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 868, datë 11.11.2020	Për emërim në detyrë..... 14238
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 869, datë 11.11.2020	Për kalimin në pronësi të Bashkisë Korçë të një sipërfaqeje trualli funksional e të një objekti në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, brenda territorit të pronës nr. 1211, me emërtim “Ish-batalion AT”, me vendndodhje në Dardhë, Korçë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar..... 14238
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 11.11.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 1128, datë 5.8.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, të ndryshuar..... 14242
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 871, datë 11.11.2020	Për lirin dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Tiranës..... 14243
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 872, datë 11.11.2020	Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2021, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)..... 14243
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 11.11.2020	Për përcaktimin e rasteve dhe të mënyrës së bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror e njësisë të vetëqeverisjes vendore, për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale..... 14243

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 875, datë 11.11.2020	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti: “Ndërtimi i nënstacionit 400/110/20 kV, Tërana 3”.....	14246
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 11.11.2020	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti: “Rikonstruksion sheshi ‘Ismail Qemali’ dhe rruga ‘Veterani’, Bashkia Pogradec”.....	14247
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 877, datë 11.11.2020	Për miratimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas (datë 30 qershor 2008, marrëveshje huaje nr. ABA-P3) ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (të zëvendësuar nga Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar në tetor 2008), për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e Madhe”, ratifikuar me ligjin nr. 9964, datë 24.7.2008.....	14248
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 878, datë 11.11.2020	Për miratimin e planit të veprimit 2020–2023, në zbatim të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019–2023.....	14249
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 879, datë 11.11.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar.....	14272
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 880, datë 11.11.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Durrës, Lezhë dhe Kamzë.....	14272
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 881, datë 28.10.2020	Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj.....	14273
Udhëzim i ministrit të Kulturës nr. 443, datë 4.11.2020	Për miratimin e formatit të kërkesës, dokumentacionit shoqërues dhe procedurës së shqyrtimit të dokumentacionit nga ana e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Muzeve, për Krijimin e Muzeve.....	14276
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 334, datë 10.11.2020	Për hapjen e institucionit arsimor parauniversitar publik të arsimit parashkollor, kopshti në fshatin Losnik, Njësia Administrative Velçan, Bashkia Pogradec.....	14280
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 335, datë 10.11.2020	Për hapjen e institucionit arsimor parauniversitar publik të arsimit parashkollor, kopshti në fshatin Homçan, Njësia Administrative Proptisht, Bashkia Pogradec.....	14281
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 442, datë 4.11.2020	Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Muzeve dhe Sekretarisë Teknike.....	14282

**DEKRET**

Nr. 11809, datë 4.11.2020

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Gleni Maksim Lamani
2. Besmira Estref Rrapaj
3. Jon Gazmend Ibraimi
4. Amla Gazmend Ibraimi
5. Brunilda Koçi Danga (Tahiri)
6. Angelo Joel Alqi Danga
7. Anisa Safet Xhaferaj (Dule)
8. Elidon (Eldon) Sali Xhaferaj
9. Aurora Kreshnik Merdari
10. Erik Kreshnik Merdari
11. Ailda Albert Bejko
12. Yasin Erdal Varli
13. Ediz Erdal Varli
14. Yener Erdal Varli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM

Nr. 866, datë 11.11.2020

**PËR DHËNIEN ME QIRA, ME TARIFË
TË REDUKTUAR, TË SALLËS OVALE
“B” DHE TË ZYRAVE ME NUMRA 2/1, 3,
3/1, 6, 7 E 11, NË AMBIENTET E
PALLATIT TË KONGRESEVE,
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 784 e 801, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 8, të kreut III, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare për dhënie me qira, me tarifë të reduktuar, të sallës ovale “B” dhe të zyrave me numra 2/1, 3, 3/1, 6, 7 e 11, të ndodhura në ambientet e Pallatit të Kongreseve, Komisionit të Prokurimit Publik, për ushtrimin e veprimtarisë së tij.

2. Tarifa e qirasë së sallës ovale “B” dhe e zyrave me numra 2/1, 3, 3/1, 6, 7 e 11 të jetë në masën ekuivalente të shpenzimeve operative (furnizim me energji elektrike dhe ujë) gjatë gjithë periudhës së dhënies me qira.

3. Ngarkohen Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare dhe Komisioni i Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



VENDIM

Nr. 868, datë 11.11.2020

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Besart Kadia emërohet zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 869, datë 11.11.2020

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË KORÇË TË NJË SIPËRFAQEJE
TRUALLI FUNKSIONAL E TË NJË
OBJEKTI NË ADMINISTRIM TË
MINISTRISË SË MBROJTJES, BRENDA
TERRITORIT TË PRONËS NR. 1211, ME
EMËRTIM “ISH-BATALION AT”, ME
VENDNDODHJE NË DARDHË, KORÇË,
DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË MBROJTJES”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Korçë të një sipërfaqeje trualli funksional dhe të një objekti në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1 812 (një mijë e tetëqind e dymbëdhjetë) m², nga trualli funksional i pronës nr. 1211, me emërtim “Ish-batalion AT”, me vendndodhje në Dardhë, Korçë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ndërtim rrugë publike, për zhvillimin e projektit “Ndërhyrje për përmirësimin e segmentit rrugor Boboshticë–Dardhë”.

2. Bashkisë Korçë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.

3. Për sigurinë dhe ruajtjen e pronës, para fillimit të punimeve, Bashkia Korçë të ndërtojë rrethimin në kufijtë e rinj të pronës dhe çdo element që lidhet me rrethimin, duke i kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme, të kryejë zhvendosjen e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e sipërfaqes së pronës, e cila i kalon në pronësi, sipas parametrave dhe kushteve teknike, e për këtë të hartohet aktmarrëveshje ndërmjet Bashkisë Korçë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, të përfaqësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Komanda Mbështetëse.


4. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet sipërfaqja prej 1 812 (një mijë e tetëqind e dymbëdhjetë) m² nga trualli funksional i pronës nr. 1211, me emërtim “Ish-batalion AT”, me vendndodhje në Dardhë, Korçë, sipas planvendosjes dhe përmasat e kësaj prone të zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin standard të inventarizimit e në planvendosjen që i bashkëlidhen këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Korçë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen e zbatimit e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe





PLAN RILEVIMI Prona nr. 1211 "Ish batalion Artileri Tokësore" Dardhë, Korçë (Sip. dhe objektet që ndihen pronës pas kalimit të Sip. dhe Objektit të kërkuara nga Bashkia e Korçës)	IDENTIFIKIMI I PASURISE Zona Kadastrale 1446 Nr. Pasurise Vol. Fq Indeksi i Hartes K-34-126-(123-A) Shkalla 1: 2500 Adresa e pasurise Korçë Q/F Dardhë, Korçë Pronari : Ministria e Mbrojtjes, Komanda Mbështetëse
MIRATOHET Komandanti i Komandës Mbështetëse Gjeneral Brigade Ndriçim SALLAKU Hartoi Topograf Ramiz Haxhiu Ripunuar Gusht 2020	DREJTORI I IGJIU Ark. Enea SINOIMERI
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH) N 4487412.52 E 569843.45 N 4487412.52 E 570045.82 DARDHË Shënim: Ky planrilevimi u hartua në zbatim të shkresës së Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura nr.3782/1, datë 20.07.2020, bazuar në dokumentacionin hartografik të kësaj prone marrë në arkivin e IGJIU-së.	
Shpjeguese = 13 470.99m² Sipe Pergi. e Pronës = 281.64m² (objekti është tjetërsuar përshtatur për banesë) Sip. nën objekte = 281.64m² Kufiri i repartit	



FORMULARI PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTESHME SHETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Ministria e Mbrojtjes Komanda Mbeshetese						
Identifikikoi: Civil Rifat HASA, Specialist për Pronat në KM Civil Leonora AVDO, Specialist për Pronat në KM						
Supervizoi: Major Arben SOPAJ, Specialist për Pronat në KM N/Kolonele Rudina KADRIU, Shefi i Degës së Përmes në KM						
Aprovoi: Gjeneral Ndriçim SALLI, Komandant i KM						
Nr-i Prones	Zona Kadastrale, Indeksi i Hartes	Nr. i pasurisë	Emertesa e pronës, Vendndodhja, Shiritja Gjeografike	Sipas dok. tek. dhe identifikimit ne terren	Adresa e vendndodhja e komponentit e perberes	Funksioni për të cilin perdoret prona
				Komponentet perberes te prones	Enti i pergjegjesiv administrativ e juridik i perdorimit	Te dhena te tjera, shenime te vecanta
1211	1446 K-34-126 - (123-A)		Ish Batalion Artillerie Tokesore	Permasat e prones ne m2 ose ml	Dardhe Korçe	Per Mbrojtjen
				13470.99		MM., Rep. Ushit. Nr.4001
						Rep. Ushit. Nr.4001
						Prona u identifikua në zbatim të shkresës së Shetit të Shkallit të Pergjithshëm të FA-së me nr.3872/I, datë 20.07.2020, pjesa që do i mbetet Komandes Mbeshetese ne rast transferimi
				Ish komand 2 kt		Regjistruar nga persona te trete
				PZ tip tunel		
				Truall		
				13189.59		

**VENDIM****Nr. 870, datë 11.11.2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 1128, DATË 5.8.2008, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE
ADMINISTRIMIN E MALLRAVE
REZERVË MATERIALE
SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 6 e 10, të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tabela e grupit “C”, në lidhjen nr. 1, “Lista e mallrave rezervë materiale shtetërore sipas grupeve, e ndarë në lloje dhe sasi”, bashkëlidhur vendimit nr. 1128, datë 5.8.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

GRUPI C

Nr.	Artikulli	Njësia matëse	Gjendja orientuese e mallrave (sasia)	Limiti minimal
1	Çadra strehimi	copë	700	500
2	Mjedise të përkohshme (rulotë, kontejnerë)	copë	100	50
3	Krevate portative me dyshekë	copë	5000	3000
4	Çarçafë dhe këllëfë jastëku	copë	8000	5000
5	Jastëkë	copë	8000	5000
6	Batanije	copë	8000	5000
7	Çizme gome	copë	10000	8000
8	Sete kuzhine	copë	5000	1000
9	Pajisje elektroshtëpiake	copë	1000	500
10	Miell	ton	400	200
11	Ujë mineral natyral	litra	5000	3000
12	Oriz	ton	80	40
13	Sheqer	ton	80	40
14	Makarona	ton	70	30
15	Vaj ushqimor	ton	50	30
16	Fasule	ton	50	30
17	Konserva mishi	ton	20	10
18	Kripë	ton	5	2
19	Sapun	copë	30000	15000
20	Detergjent	ton	30	10
21	Ushqim i koncentruar (koncentrat) për kafshët	ton	120	60
22	Ushqim voluminoz (bar i thatë dhe kashtë) për kafshët	ton	180	90



VENDIM
Nr. 871, datë 11.11.2020

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË TIRANËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Suzana Jahollari, prefekt i qarkut të Tiranës, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Toni Gogu emërohet prefekt i qarkut të Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 872, datë 11.11.2020

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2021, TË
ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT
TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË
UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2021, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), në shumën 51 919 550 (pesëdhjetë e një milionë e nëntëqind e

nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)

PASQYRA NR. 1
PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2021

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2021 (lekë)
1	Pagat dhe shtesat e tjera	31,638,500
2	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	5,294,200
3	Shërbime e furniturë	14,301,850
4	Investime	685,000
	TOTALI	51,919,550

VENDIM
Nr. 873, datë 11.11.2020

PËR PËRCAKTIMIN E RASTEVE DHE
TË MËNYRËS SË BASHKËPUNIMIT
NDËRMJET PUSHTETIT QENDROR E
NJËSIVE TË VETËQEVERISJES
VENDORE, PËR KRIJIMIN OSE
SHTIMIN E FONDIT PUBLIK TË
BANESAVE SOCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi:

a) i rasteve të bashkëpunimit, ndërmjet pushtetit qendror e njësive të vetëqeverisjes vendore, për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale; dhe

b) i mënyrës së bashkëpunimit, ndërmjet pushtetit qendror e njësive të vetëqeverisjes vendore, për këtë qëllim.



2. Bashkëpunimi ndërmjet pushtetit qendror e njësisve të vetëqeverisjes vendore realizohet në të gjitha rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore kërkojnë mbështetje financiare ose administrative nga ministria përgjegjëse për strehimin për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale në pronësi të tyre.

3. Mbështetja financiare për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale, sipas mënyrave të përcaktuara në pikën 1, të nenit 18, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, i akordohet njësisë së vetëqeverisjes vendore nga ministria përgjegjëse për strehimin, brenda tavaneve buxhetore të miratuara çdo vit për strehimin dhe bazuar në:

a) nevojat e evidentuara në planet vendore 5-(pesë-) vjeçare të strehimit;

b) plotësimin e nevojave nëpërmjet banesave me qira në pronësi të pronarëve socialë;

c) mundësitë e bashkëfinancimit nga të ardhurat e veta të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të parashikuara në buxhetin vendor afatmesëm, atë vjetor e të miratuar me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore;

ç) financime të mundshme nga subjekte private fitimprurëse, jofitimprurëse dhe donacione;

d) kërkesën për mbështetje financiare, së bashku me përqindjen e bashkëfinancimit nga të ardhurat vendore, miratuar nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore;

dh) udhëzimin nr. 3, datë 18.11.2019, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”.

4. Ministria përgjegjëse për strehimin bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore në rastet kur kërkohet krijimi ose shtimi i fondit publik të banesave sociale nëpërmjet transferimit të pronave në emër të njësisve të vetëqeverisjes vendore për t’u përshtatur në banesë sociale me qira.

5. Në rastin e parashikuar në pikën 4, të këtij vendimi, ndiqen procedurat e përcaktuara në vendimin nr. 458, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e kthimit në fond banese, me qëllim strehimi, të objekteve pronë shtetërore, që përshtaten nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me grante konkurruese nga buxheti i shtetit”.

6. Njësitë e vetëqeverisjes vendore i kërkojnë mbështetje administrative ministrisë përgjegjëse për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, në rast të kalimit të pronësisë ose të administrimit mbi pronat e konfiskuara, si pasuri të vëna me aktivitet të paligjshëm.

7. Në rastin e parashikuar në pikën 6, të këtij vendimi, ndiqet procedura e mëposhtme:

a) Njësia e vetëqeverisjes vendore, pasi ka verifikuar mundësinë e përdorimit për strehim social të objektit të konfiskuar, i drejtohet me kërkesë me shkrim ministrisë përgjegjëse në varësi të së cilës është Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara;

b) Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara përgjigjet për përgatitjen e dokumentacionit përkatës, bazuar në kërkesën e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe për paraqitjen e këtij dokumentacioni pranë Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar;

c) Pasi merret miratimi nga Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për strehimin, i propozojnë Këshillit të Ministrave kalimin e objektit në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse;

ç) Në rastet kur prona destinohet të bëhet pjesë e fondit publik të banesave sociale me qira, por mbetet në pronësi të pushtetit qendror, objekti kalon në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.

8. Mbështetja financiare i akordohet Entit Kombëtar të Banësive për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale në pronësi të pushtetit qendror, kur ky i fundit aplikon për mbështetje financiare nëpërmjet ndërtimit ose përshtatjes së objekteve ekzistuese, sipas studimit të fizibilitetit të hartuar nga Enti Kombëtar i Banësive dhe kur ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me njësinë e vetëqeverisjes vendore, e cila parashikon, ndër të tjera:

a) kalimin e pronësisë së truallit, pronë shtetërore ose në pronësi të qeverisjes vendore, ose të objektit ekzistues, së bashku me truallin në emër të Entit Kombëtar të Banësive, me qëllim investimin në banesa sociale me qira;

b) bashkëfinancimin nga të ardhurat e Entit Kombëtar të Banësive për realizimin e projektit;



c) nivelin e qirasë, që duhet të mbulojë kthimin e pjesës së investimit të realizuar me të ardhurat e Entit Kombëtar të Banesave, si dhe kostot për administrimin e mirëmbajtjen e banesave sociale;

ç) subvencionimin nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të qirasë për familjet që do të strehohen, sipas aftësisë së tyre përballuese.

9. Njësitë e vetëqeverisjes vendore krijojnë regjistrin e fondit të banesave sociale në pronësinë e tyre, që përdoren për t'u dhënë me qira. Për çdo banesë sociale regjistri përmban:

a) informacionin gjeohapësinor të vendndodhjes së banesave, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 359, datë 11.5.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – Tema: Ndërtesat”;

b) planvendosjen e tyre;

c) planimetrinë e apartamenteve;

ç) informacionin për gjendjen teknike të çdo apartamenti;

d) vlerën e investimit fillestar;

dh) vlerën e investuar për rehabilitimin ose rinovimin e tyre;

e) vitin kur ka përfunduar ndërtimi;

ë) vitin kur janë bërë punimet e rinovimit;

f) subjektin që është ngarkuar ose kontraktuar për menaxhimin e tyre.

10. Në një faqe të posaçme të regjistrit të fondit të banesave sociale hidhen të dhënat për banesat në pronësi të pronarit social, për atë kohë sa ato janë në përdorim si banesa sociale me qira vetëm për efekt të evidentimit të qëllimit të tyre dhe të lehtësimit të menaxhimit e mbikëqyrjes së kontratës së qirasë, për të cilën paguhet subvencioni nga njësia e vetëqeverisjes vendore, nga buxheti i shtetit ose nga të dyja bashkë. Krahas informacionit të parashikuar në pikën 8, të këtij vendimi, për banesat në pronësi të pronarit social evidentohen edhe të dhënat që lidhen me kontratën e lidhur me pronarin e tyre dhe kushtet kryesore kontraktore, të tilla si: afati e vlera e qirasë. Këto banesa vazhdojnë të mbeten në pronësi të pronarit social dhe nuk bëhen pjesë e fondit publik të banesave sociale që janë në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore. Pronarët socialë detyrohen që, me anë të personave përgjegjës të autorizuar nga drejtuesi i tyre, të depozitojnë informacionin

me të dhënat e parashikuara në këtë pikë të këtij vendimi, pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore.

11. Ministria përgjegjëse për strehimin nëpërmjet strukturës përgjegjëse për strehimin monitoron mënyrën e administrimit e të përdorimit të fondeve nga buxheti i shtetit në rastet e financimeve apo bashkëfinancimeve nga buxheti i shtetit lidhur me:

a) verifikimin e përmbushjes së qëllimit të përdorimit të fondit nga buxheti i shtetit të dedikuar për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale;

b) mbikëqyrjen e hapave ligjorë, me qëllim administrimin e këtyre fondeve;

c) mbikëqyrjen e procedurave që lidhen me ndërtimin, me blerjen ose me dhurimin e banesave që bëhen pjesë e fondit publik të banesave sociale.

12. Konkluzionet që mund të dalin nga monitorimi i përcillen kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, me qëllim përmirësimin e administrimit e të përdorimit të fondeve nga buxheti i shtetit.

13. Njësitë e vetëqeverisjes vendore i raportojnë ministrisë përgjegjëse për strehimin, brenda muajit dhjetor të çdo viti, për numrin e banesave sociale të regjistruara në regjistrin vendor e formën e sigurimit të tyre edhe kur ato janë siguruar vetëm me të ardhurat e njërive të vetëqeverisjes vendore, me anë të dhurimit ose me forma të tjera të parashikuara në ligjin për banesat sociale.

14. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përditësojnë bazën e të dhënave gjeohapësinore për banesat sociale, duke i përcjellë informacionin, sipas shkronjës “a”, të pikës 8, të këtij vendimi, Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) për publikim në Gjeoportalin Kombëtar që administrohet nga ASIG-u.

15. Ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin, ministria përgjegjëse në varësi të së cilës është Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, Enti Kombëtar i Banesave dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për ndjekjen e zbatimit e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Erion Braçe



VENDIM
Nr. 875, datë 11.11.2020

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA PROJEKTI:
“NDËRTIMI I NËNSTACIONIT
400/110/20 kV, TIRANA 3”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti: “Ndërtimi i nënstacionit 400/110/20 kV, Tirana 3”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të “Operatorit të Sistemit të Transmetimit” sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 18 711 640 (tetëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 18 711 640 (tetëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekësh, të përballohet nga “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a.

5. Vlera për shpenzimet procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të

përballohet nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, në zyrat e “Operatorit të Sistemit të Transmetimit” sh.a.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me “Operatorin e Sistemit të Transmetimit” sh.a., të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të “Operatorit të Sistemit të Transmetimit” sh.a.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe



LISTA PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT:
“NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400/110/20 kV, TIRANA 3”

Nr.	Emër, Mbiemër	Lloji i pasurisë	Z.K.	Nr. i pasurisë	Sip. e pronës m ²	Sip. e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m ²	Vlera e shpronësimit në lekë
1	Qemal Metoja	Arë	2947	371/5	9200	9200	470	4,324,000
2	Artur Xhemzi Sinanaj Ferdinand Xhemzi Sinoma	Arë	2947	371/6	9000	9000	470	4,230,000
3	Myrteza Gjashta	Arë	2947	371/11	8000	1700	470	799,000
4	Mustafa Mahmut Kupi	Arë	2947	371/12	3450	3450	470	1,621,500
5	Bashkëpronësi Aqif dhe Shaban Sina	Arë	2947	371/13	4039	4039	470	1,898,330
6	Bashkëpronësi Aqif dhe Shaban Sina	Arë	2947	371/14	500	500	470	235,000
7	Pietro Durim Kuqi	Arë	2947	371/15	1500	1500	470	705,000
8	Muhamet Abdulla Zaja	Arë	2947	371/16	5000	5000	470	2,350,000
9	Bashkëpronësi Aqif dhe Shaban Sina	Arë	2947	371/17	261	261	470	122,670
10	Jakup Kupi	Arë	2947	371/18	2000	2000	470	940,000
11	Mustafa Isak Doda	Arë	2947	371/19	2000	2000	470	940,000
12	Bashkëpronësi, familjet Çejku, Çala, Domi, Gjana, Çajku	Arë	2947	5/1/6	14950	457	470	214,790
13	Bashkim Isuf Kupi	Arë	2947	5/1/7	7000	220	470	103,400
14	Isuf Jakup Kupi	Arë	2947	5/1/8	1000	41	470	19,270
15	Mustafa Kupi	Arë	2947	5/1/9	14200	444	470	208,680
Sipërfaqe totale shpronësimi m ²						39812		
Vlera totale								18,711,640

Vlerësimi për pasuritë “tokë arë” është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, date 3.2.2016.

VENDIM Nr. 876, datë 11.11.2020

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA PROJEKTI: “RIKONSTRUKSION SHESHI ‘ISMAIL QEMALI’ DHE RRUGA ‘VETERANI’, BASHKIA POGRADEÇ”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti: “Rikonstruksion sheshi ‘Ismail Qemali’ dhe rruga ‘Veterani’, Bashkia Pogradec”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Pogradec.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi,

për pasurinë e llojit tokë “truall”, me vlerë 4 107 226.5 (katër milionë e njëqind e shtatë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë pikë pesë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 107 226.5 (katër milionë e njëqind e shtatë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë pikë pesë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Bashkisë Pogradec.

8. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Pogradec.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në bashkëpunim me Bashkinë Pogradec, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të



bëjnë kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë Pogradec.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Pogradec.

11. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI:
“RIKONSTRUKSION SHESHI ‘SMAIL QEMALI’ DHE RRUGA ‘VETERANT’, BASHKIA POGRADEC”

Çmimi për pasurinë “truall” është llogaritur sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016.

Nr.	Emër, Atësi, Mbiemër	Zona kadastrale	N./pasurisë	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ASHK-ja
1	Agim Muhamet Prishtina, Petrit Muhamet Prishtina, Bukurie Tosum Prishtina, Lumturie Muhamet Prishtina, Luiza Muhamet Prishtina, Argjen Muhamet Prishtina	8581	5/279	truall	m ²	391.5	10491	4,107,226.50	Konfirmuar nga ASHK-ja me shkresën nr. 1266/1, datë 21.2.2019
Shuma totale e shpronësimit						391.5		4,107,226.50	

VENDIM
Nr. 877, datë 11.11.2020

**PËR MIRATIMIN E
LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE
TË MARRËVESHJES SË HUAS (DATË 30
QERSHOR 2008, MARRËVESHJE HUAJE
NR. ABA-P3) NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS JAPONEZE PËR
BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (TË
ZËVENDËSUAR NGA AGJENCIA
JAPONEZE E BASHKËPUNIT
NDËRKOMBËTAR NË TETOR 2008),
PËR PROJEKTIN “PËRMIRËSIMI I
SISTEMIT TË KANALIZIMEVE PËR
TIRANËN E MADHE”, RATIFIKUAR ME
LIGJIN NR. 9964, DATË 24.7.2008**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas (datë 30 qershor 2008, marrëveshje huaje nr. ABA-P3) ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (të zëvendësuar nga Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit
Faqe | 14248

Ndërkombëtar, në tetor 2008), për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”, ratifikuar me ligjin nr. 9964, datë 24.7.2008, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Agjencia për Bashkëpunim Ndërkombëtar
Japonez
Datë 8 nëntor 2019
Ref. nr. JICA (7R) 11-07001

Ministria e Financave dhe Ekonomisë,
Republika e Shqipërisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë,
Shqipëri

Drejtuar: Sh.S. znj. Anila Demaj
Ministre e Financave dhe Ekonomisë,
Republika e Shqipërisë

Marrëveshja e Huas nr. ABA-P3, datë 30 qershor 2008, për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve në Tiranën e Madhe”.

Në referencë të letrës suaj nr. 17272/1, të datës 9 tetor 2019, dhe të notës verbale nr. 078/2019, datë 24 tetor 2019, të Ambasadës së Japonisë në Republikën e Shqipërisë, drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, e cila shpreh



pëlqimin e Qeverisë Japoneze për kërkesën e Republikës së Shqipërisë për zgjatjen e periudhës së disbursimit të Marrëveshjes së lartpërmendur të Huas, me anë të kësaj biem dakord si më poshtë:

1. Seksioni 2(2) i nenit I, që të Marrëveshjes së lartpërmendur të Huas, ndryshohet si më poshtë:

“Disbursimi përfundimtar sipas Marrëveshjes së Huas do të kryhet jo më vonë se data 24 prill 2022 dhe pas kësaj date nga ana e JICA-së nuk do të kryhet asnjë disbursim i mëtejshëm, përveçse kur bihet dakord ndërmjet JICA-së dhe Huamarrësit.”.

2. Ky ndryshim hyn në fuqi nga data kur JICA njoftohet se kanë përfunduar procedurat e nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Huas së lartpërmendur në Republikën e Shqipërisë.

3. Kjo letër nuk do të interpretohet për të autorizuar ndonjë ndryshim tjetër përveç atij të përmendur më lart.

Në momentin që përfundojnë procedurat e nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së lartpërmendur të Huas në Republikën e Shqipërisë, ju lutem konfirmoni miratimin tuaj për amendimin e mësipërm, duke nënshkruar atë dhe kopjen bashkëlidhur kësaj shkrese, duke ruajtur një kopje tuajën dhe duke na kthyer kopjen tjetër.

Me respekt,

AGJENCIA PËR BASHKËPUNIM
NDËRKOMBËTAR JAPONEZ

Nga: Nënshkrimi
Takema Sakamoto
Drejtor i Përgjithshëm
Departamenti i Lindjes së Mesme dhe Evropës

Konfirmuar:

Në datën 29.7.2020 _____

Për: MINISTRINË E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nga: MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Anila Denaj

Në vëmendje të: Përfaqësuesit Kryesor, Zyra
Ballkanike JICA

VENDIM
Nr. 878, datë 11.11.2020

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
VEPRIMIT 2020–2023, NË ZBATIM TË
STRATEGJISË SË EDUKIMIT LIGJOR
PËR PUBLIKUN 2019–2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit 2020–2023, në zbatim të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019–2023, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, ministritë e linjës, si dhe institucionet e subjektet e përmendura në planin e veprimit për ndjekjen e zbatimit e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe



TABELA 1

PLANI I VEPRIMIT, 2020–2023, NË ZBATIM TË STRATEGJISË SË EDUKIMIT LIGJOR TË PUBLIKUT, 2020–2023

I. QËLLIMI STRATEGJIK: Investimi në kapitalin njerëzor dhe kohezionin social

Nr.	Masat në zbatim të objektivave specifike	Referenca e rezultatit me produktet e programit buxhetor	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikative (në mijë lekë)	Burimi i mbulimit		
			Institucioni përgjegjës	Institucion kontribuues (nëse ka)	Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Buxheti i shtetit	Financim i huaj	Hendeku financiar
QËLLIMI I POLITIKËS 1: Përmirësimi i organizimit dhe funksionimit institucional në ofrimin e ELP-së										
Programi buxhetor që kontribuon për qëllimin e politikës: 1002001 (01120) Kuvendi; 1088001 Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile; Programi 01110 Planifikim Menaxhim Administrim - Ministria e Drejtësisë/Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë/ Ministria e Brendshme/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Kodi Programit Tregu i Punës 10550;										
1.1	Objektivi specifik 1.1: Përmirësimi i legjisllacionit me qëllim parashikimin e parimeve e formave të ELP-së dhe përfshirjen e ELP-së në përgjegjësitë e institucioneve									
1.1.1	Raporti i vlerësimit të nevojave për përmirësim të kuadrit ligjor dhe institucional të ELP-së i hartuar				2020	2020	515			
1.1.1 a	Ngritja e Grupit Institucional të Punës për kryerjen e studimit mbi nevojat për përmirësim të kuadrit ligjor dhe institucional (I) Hartimi i raportit paraprak mbi nevojat (II) Konsultimi i raportit paraprak me anëtarët e Rrjetit (III) Hartimi dhe publikimi i raportit përfundimtar mbi nevojat për përmirësim të kuadrit ligjor dhe institucional të ELP (IV)	91401AA	MD	Ministritë (anëtarë të Rrjetit)	6M I 2021	6M I 2021	515	515		



1.1.2	Akte ligjore dhe nënligjore të hartuara dhe të miratuara, në përputhje me rekomandimet e raportit përfundimtar të vlerësimit të ELP-së				2021	2023	1,193			
1.1.2 a	Numri i akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara dhe të miratuara	91401AA(MD) 91101AD (MASR)	Ministritë (anëtarë të Rrjetit)		6M II 2021	6M II 2023	1,193 (MD) Ministritë e tjera kosto administrative	1,193		
1.1.2 b	Numri i akteve nënligjore për NJQV-të: (Rregullorja për konsultimin publik/ Rregullorja për të Drejtën e Peticionit, Ankesave dhe iniciativën qytetare/Rregullorja e Këshillit Bashkiak/Mbështetje për ndërgjegjësimin e bashkive në lidhje me detyrimet mbi ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" /Përmirësimi i akteve ligjore/nënligjore për Prefektin e qarkut *Aktet që do të/mund të ndryshohen do të parashikohen saktësisht në varësi të kërkesave të institucioneve propozuese	91602AC	MB	Shoqata e Bashkive	6M II 2021	6M II 2023	Kosto administrative			
2	Objektivi Specifik 1.2: Rritja e vazhdueshme e burimeve financiare nga buxheti i shtetit dhe donatorët për ofrimin e ELP-së									
1.2.1	Aktivitetet ndërgjegjëse dhe advokuese për rritjen e nivelit të financimit të aktiviteteve të parashikuara në PV të SELP nga donatorët, të realizuara				2020	2021	515	515		



1.2.1 a	Krijimi i databazës së donatorëve që mbështesin aktivitete të ELP-së	91401AA	MD	Ministritë (anëtarë të Rrjetit) OSHC-të	6M II 2021	6M II 2021	515	515		
1.2.1 b	Zhvillimi i një konference kombëtare për të rritur ndërgjegjësimin e përdorimit të ELP-së	90202AA	Kuvendi	Ministritë (Anëtarë të Rrjetit) OSHC	6M I 2021	6M I 2021	Kosto administrative			
1.2.2	Përmirësimi i planifikimit buxhetor të institucioneve publike dhe përfshirja në prioritetet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) të ELP-së				2020	2023	40, 400	40, 400		
1.2.2.a	Integrimi në prioritetet e AMSHC-së (thirrje për projekte) në fushën e edukimit ligjor të publikut	98801 AA	AMSHC		6M II 2020	Në vijim	40, 400	40, 400		
1.3	Objektivi Specifik 1.3: Sigurimi i burimeve njerëzore të nevojshme për të mundësuar ndërhyrjen me efektivitet në ofrimin e ELP-së									
1.3.1	Identifikimi e vlerësimi i nevojave për burime njerëzore në nivel qendror dhe vendor				2020	2020	317	317		
1.3.1 a	Përcaktimi i një koordinatori që ofron edukimin/orientimin ligjor të publikut, në institucionet qendrore dhe vendore	91401AA	Ministritë (anëtarë të Rrjetit) NJQV		6M I 2021	6M I 2021	317	317		
1.3.1 b	ELP i të papunëve, kryesisht i grupeve në nevojë mbi legjislacionin në fushën e punësimit, migracionit për motive punësimi dhe arsimit e formimit profesional	Kodi MFE 10	MFE	Institucionet e varësishë (Zyrat rajonale dhe vendore të punësimit)	6M I 2021	6M II 2021	Kosto administrative			



QËLLIMI STRATEGJIK 2: Garantimi dhe forcimi i bashkëpunimit efektiv ndërinstitucional në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor për realizimin e ELP-së

Programi buxhetor që kontribuon për qëllimin e politikës: 1002001 (01120) Kuvendi; 03310 Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas; Programi 01110 Planifikim Menaxhim Administrim - Ministria e Drejtësisë/Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë/ Ministria e Brendshme/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

2.1	Objektivi Specifik 2.1: Institucionalizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim koordinimin dhe bashkërendimin e iniciativave të ELP-së									
2.1.1	Krijimi i strukturës (Rrjeti) ndërinstitucionale përgjegjëse për edukimin ligjor të publikut dhe përcaktimi i kuadrit rregullator të veprimtarisë së tij				2020	2020	Kosto administrative			
2.1.1 a	Rregullore e Rrjetit e hartuar dhe e miratuar (I); publikim/njoftim i ngritjes së Rrjetit (II) faqja <i>web</i> e Rrjetit e ngritur dhe funksionale; nr. i publikimeve të kryera në <i>web</i>)	90202AA	Kuvendi		6M I 2020	6M I 2020	Kosto administrative			
2.1.2	Transparencë e shtuar e veprimtarisë dhe aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të ELP-së				2020	2023	Kosto administrative			
2.1.2 a	Përditësimi i faqes <i>web</i> të krijuar (I) Hedhja e të dhënave mbi aktivitete që ndërmerren për ELP-në në fushën e legjislacionit sipas fushës së përgjegjësisë së çdo ministrie (anëtarë të Rrjetit) dhe të autoriteteve tjera publike	90202AA	Kuvendi	Autoritete Publike (anëtarë të Rrjetit)	6M I 2020	Në vijim	Kosto administrative			
2.1.2 b	Aktivitete ndërgjegjësuëse e advokuese ndaj institucioneve përgjegjëse për ofrimin e ELP-së me qëllim edukimin ligjor për PAK	96601AA	MSHMS	OSHC	6M I 2022	6M II 2022	Kosto administrative			



2.1.3	Krijimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i mekanizmave të bashkëpunimit dhe komunikimit të Rrjetit me publikun dhe median				2020	2023	Kosto administrative			
2.1.3 a	Caktimi i personit përgjegjës për komunikimin e Rrjetit me median dhe publikun (I) Komunikim\i dhe ndërveprimi midis institucioneve publike dhe qytetarëve dhe medias në kuadër të ELP-së, i përmirësuar dhe i lehtësuar (II)	90202AA	Kuvendi		6M I 2020	Në vijim	Kosto administrative			
2.2	Objektivi Specifik 2.2: Zhvillimi i mekanizmave të bashkëpunimit e komunikimit me publikun e median									
2.2.1	Plani i Komunikimit të Rrjetit me publikun dhe median (“Plani i Komunikimit”) i hartuar				2020	2023	Kosto administrative			
2.2.1 a	Hartimi, konsultimi dhe miratimi i Planit të Komunikimit të Rrjetit (I) Plani i Komunikimit të Rrjetit i rishikuar (në vijimësi për çdo vit zbatimit të PV)	90202AA	Kuvendi	Autoritete Publike (anëtare të Rrjetit)	6M II 2020	Në vijim	Kosto administrative			
2.2.1 b	Marrëveshje bashkëpunimi me NJQV-të për të vendosur standardin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit reciprok në planifikimin e aktiviteteve	91602AC	MB/AMVV	NJQV	6M II 2020	Në vijim	Kosto administrative			
2.3	Objektivi Specifik 2.3: Konkretizimi i bashkëpunimit ndërinstitutional nëpërmjet realizimit të iniciativave të përbashkëta të ELP-së									
2.3.1	Iniciativat e përbashkëta ndërinstitutionale të ELP-së të zhvilluara dhe përditësuara (të paktën 3 iniciativa/vit)				2020	2023	7,055		7,055	



2.3.1 a	Edukimi ligjor i grupeve të interesit për heqjen e qeses plastike nga përdorimi		MTM	OSHC	6M I 2021	6M II 2021	1, 055		1, 055	
2.3.1 b	Edukimi ligjor i grupeve të interesit mbi kuadrin ligjor të përditësuar për barazinë gjinore/DHBGJ dhe dhuna në familje në kuadër të fushatës “16 ditët e aktivizimit të DHBGJ” *Aktiviteti kryhet çdo vit në periudhën 25 nëntor–10 dhjetor		MSHMS	OSHC	6M II 2020	6 M II 2023	4,000		4,000	
2.3.1 c	Edukimi ligjor i qytetarëve dhe grupeve në nevojë mbi ligjin për ndihmën juridike falas, shërbimet sociale të ofruara nga Bashkitë dhe procedurat e ankimit (fletëpalosje, broshura, edukim ligjor në 12 njësi administrative, intervista televizive, forume).		IAL Shkodër, NJQV Kukës, Lezhë, Kurbin	OSHC	6M I 2020	6M I 2021	2,000		2,000 Worldvision/BE	
2.3.2	Instrumentet për veprimtaritë dhe bashkëpunimin në fushën e ndihmës juridike falas në nivel qendror dhe nivel vendor, të përmirësuar				2020	2020	115	115		
2.3.2 a	Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me OSHC-të, klinikave të ligjit për ofrimin e ndihmës juridike falas (kontrata bashkëpunimi)	Kodi i produktit DNJF 91406AA;18AR501	DNJF	IAL (klinika ligji)	6M I 2020	6M II 2020	115	115		
2.3.4	Iniciativat e përbashkëta midis OSHC-ve/klinikave të ligjit dhe organit që administron ndihmën juridike falas/DNJF të zhvilluara				2020	2023	1,673	1,673		



2.3.4 a	Fushata sensibilizimi mbi ligjin për ndihmën juridike falas (fletëpalosje/takime/aktivitete përbashkëta institucionale): Mars 2020: zhvillimi i një fushate ndërgjegjëse me aktorët e shoqërisë civile/institucionet publike në qytetin e Elbasanit (aktivitete në vijimësi gjatë kohës së zbatimit të këtij PV)	Kodi i produktit DNJF 91406AA;18AR501	DNJF	OSHC	6M I 2020	6M II 2023	966	966		
2.3.4 b	Realizimi i iniciativave të përbashkëta midis OSHC-ve/klinikave të ligjit dhe DNJF: 3 tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues të MD (Dr. Ndihmës Juridike Falas) - 6M II 2020: Aktivitet në kuadër të bashkëpunimit me klinikat e ligjit pranë IAL-ve, pas nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit	kodi i produktit DNJF 91406AA;18AR501	DNJF	Klinika e Ligjit pranë IAL publike FDUT Klinika e Ligjit pranë ëisdrom University OSHC	6M I 2020	Në vijim	357	357		
2.3.4 c	Përgatitja e kurrikulës së veçantë të trajnimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti bazuar në kërkesat dhe kategoritë e grupeve vulnerabël, të ligjit të ndihmës juridike dhe ligjit për profesionin e avokatit		DHKA	DNJF	6M II 2020	Në vijim	350			
QËLLIMI STRATEGJIK 3: Sigurimi i performancës efektive dhe efiente të institucioneve publike dhe të pavarura, medias dhe shoqërisë civile										
Programi buxhetor që kontribuon për qëllimin e politikës: 055 Shkolla e Magjistraturës; Programi 01110 Planifikim Menaxhim Administrim - Ministria e Drejtësisë/Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë/ Ministria e Brendshme/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; 98706AB Shkolla Shqiptare e Administratës Publike										
3.1	Objektivi specifik 3.1: Zhvillimi i kuadrit metodologjik të ofrimit të ELP-së nga institucionet publike, të pavarura, medias dhe shoqërisë civile									
3.1.1	Vlerësimi mbi nevojat për hartim apo përmirësime në programet e trajnimit dhe kurrikulat e hartuara				2020	2023	4,200	4,200		



3.1.1 a	Vlerësimi i detajuar mbi nevojat për hartim apo përmirësime në programet e trajnimit dhe kurrikulat, (raport i hartuar dhe miratuar -Vlerësimi i nevojave sipas institucioneve ofrues të ELP-së)	98706AB Hartim kurrikulash dhe zhvillim trajnimi	ASPA		6M I 2021`	6M II 2023	Kosto administrative			
3.1.1 b	(I) Vlerësimi i nevojave për hartimin e planit dhe programit mësimor të trajnimit fillestar për kandidatët për kancelarë (II) Hartimi i planit mësimor për kandidatët për kancelarë (III) Vlerësimi i nevojave për hartimin e programit tematik për Programin e Formimit Vazhdues (IV) Hartimi i programit tematik për Programin e Formimit Vazhdues (aktivitetet realizohen në 6M I /vit)	95501AA (Student që ndjekin ciklin e programit mësimor) 95501AB (Sesione trajnuese për magjistratë, avokatë shteti, ndihmës ligjor dhe kancelar në detyrë)	SHM		6M I 2021	6M I 2023	4,200	4,200		
3.1.2	Kapacitete profesionale të përmirësuara në fushën e ELP-së				2021	2023	3,138	2,958	180	
3.1.2 a	Formimi Fillestar të kandidatëve për kancelar i kryer (I) Provimi i Formimit Fillestar të kandidatëve për kancelar (II) Programi mësimor për numrin e caktuar të kandidatëve i zhvilluar (25 kandidatë/vit) (III) Numër trajnimesh të parashikuara/planifikuara për magjistratin e shtypit, kancelarët, kryetarët e gjykatave dhe prokurorive, nëpunësit gjyqësor (1-2 trajnime/vit) (aktivitetet realizohen 6M II/vit)	95501AA (Student që ndjekin ciklin e programit mësimor) 95501AB (Sesione trajnuese për magjistratë, avokatë shteti, ndihmës ligjor dhe kancelar në detyrë)	SHM		6M II 2020	6M II 2023	2,958	2,958		
3.1.2 b	Hartimi e rishikimi i moduleve të trajnimit për ELP-në për nëpunësit e barazisë gjinore dhe për koordinatorët vendorë të dhunës në familje/punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve/specialistët e PAK/specialistët për romë dhe egjiptianë, viktimat e veprës penale, viktimat e trafikimit, si dhe kategori të tjera në nevojë		MSHMS	ASPA OSHC	6M I 2021	6M II 2021	180		180	



3.2	Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve publike dhe të pavarura, medias dhe shoqërisë civile në ofrimin e ELP-së									
3.2.1	Përmirësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të institucioneve publike për ofrimin e ELP-së				2020	2023	5,654	5,654		
3.2.1 a	Punonjës të institucioneve publike (nivel qendror) të trajnuar (njohuri të certifikuar) lidhur me zbatimin e ELP (punonjës së administratës me njohuri të certifikuar në kuadër të ELP-së) *Aktivitetet e trajnimit kryhen gjatë të dy periudhave 6M të zbatimit në PV	91401AA	Ministritë (anëtarë të Rrjetit)	ASPA OSHC	6M I 2021	6M II 2023	1,029	1,029		
3.2.1 b	Numri e trajnimeve të trajnerëve në fushën e ELP-së, të kryera (20 pjesëmarrës/1 trajnim në vit)	95501AB (Sesione trajnuese për magjistratë, avokatë shteti, ndihmës ligjor dhe kancelar në detyrë)	SHM		6M I 2020	6M II 2023	429	429		
3.2.1 c	Raport vlerësimi për ndryshime në Strategjinë e SHM, i realizuar (I) Hartimi i raportit akademik (II)	95501AA (Student që ndjekin ciklin e programit mësimor)	SHM		6M II 2020	6M II 2023	2,100	2,100		
3.2.1 d	Rishikimin e Programit të Formimit Fillestar për kancelarët me qëllim pasqyrimin e nevojave të reja (si rregull një herë në tre vite) (I) Rishikimin e Programit të Formimit Vazhdues me qëllim pasqyrimin e nevojave të reja (si rregull për çdo vit) (II)	95501AA (Student që ndjekin ciklin e programit mësimor) 95501AB (Sesione trajnuese për magjistratë, avokatë shteti, ndihmës ligjor dhe kancelar në detyrë)	SHM		6M II 2020	6M II 2023	2,100	2,100		



3.3	Objektivi specifik 3.3: Inkurajimi për përmirësim të vazhdueshëm të kuadrit metodologjik dhe kapaciteteve të institucioneve të pavarura, medias dhe shoqërisë civile në ofrimin e ELP-së									
3.3.1	Zhvillimi i trajnimeve të përvitshme për përditësimin e njohurive të legjislacionit të ndryshuar;				2020	2023	3,675	3,675		
3.3.1 a	Identifikimi i nevojave për përmirësim të programeve/kurrikulave pas trajnimeve të kryera (I) Organizimi i <i>workshop</i> -eve/tryeza diskutimi (1/ vit)	95501AB (Sesione trajnuese për magjistratë, avokatë shteti, ndihmës ligjor dhe kancelar në detyrë)	SHM		2021	2023	1,575	1,575		
3.3.1 b	Rishikim i programeve të moduleve në kurrikulën e programit për kancelar (I) Rishikim i kalendarit të aktiviteteve trajnuese të Programit të Formimit Vazhduesh (II) (aktivitetet realizohen në 6M I/vit)	95501AA (Student që ndjekin ciklin e programit mësimor)	SHM		6M I 2020	6M I 2023	2,100	2,100		
QËLLIMI I POLITIKËS 4: Ndërgjegjësim i publikut për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të drejtës										
Programi buxhetor që kontribuon për qëllimin e politikës: 1002001 (01120) Kuvendi; 1089001 -Komisioneri për Mbrojtjen e të Drejtës së Informimit dhe të Dhënave Personale; 03310 Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas; 03320 Avokati i Popullit; “Përkujdesi dhe përfshirja sociale”, 10430 - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Programi 01110 Planifikim Menaxhim Administrim - Ministria e Drejtësisë/Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë/ Ministria e Brendshme/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; 1064001 Autoriteti i Mediave Audiovizive;										
4.1	Objektivi specifik 4.1: Rritja e aksesit të publikut në informacionin ligjor dhe pasurimi i vazhdueshëm i njohurive juridike të tyre në përputhje me nevojat specifike									



4.1.1	Hartimi i materialeve që fokusohen në tema të veçanta ligjore dhe/ose me interes për grupe të qytetarëve me nevoja të veçanta, në formate të përshtatshme lehtësisht të aksesueshme				2020	2023	150,695	25,495	125,200	
4.1.1 a	Vlerësim mbi nevojat prioritare dhe imediate të qytetarëve për ELP-të(I) Identifikimi i autoriteteve kryesore qendrore dhe vendore të cilat duhet të përmbledhin informacion ligjor në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për publikun, sipas fushës së tyre të veprimtarisë (II) Mars 2020: Aktivitet ndërgjegjësues/sesion informues mbi sistemin e ndihmës juridike falas për të miturit në Institutin e të Miturve Kavajë (përgatitje fletëpalosjesh, broshura informuese dhe manual mbi sistemin e ndihmës juridike në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme) - Brenda vitit 2020: zhvillimi i aktiviteteve/sesioneve të informimit në gjimnaze, duke filluar me qytetin e Elbasanit, aty ku është ngritur qendra e ofrimit të ndihmës juridike e duke vijuar me qytetin e Tiranës. (përgatitje e materialeve në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme). Aktivitet ndërgjegjësues mbi sistemin e ndihmës juridike falas për gratë e dënuara.	91406AA; 18AR501	DNJF	OSHC	6M I 2020	6M II 2023	941	941		
4.1.1 b	Hartimi i materialeve informuese alternative me grafika, simbole dhe shenja të përshtatura me kategoritë e përfituesve dhe aftësitë e tyre për marrjen e informacionit *Aktivitete që vijnë përgjatë kohës së zbatimit të PV	91406AA; 18AR501	DNJF	OSHC	6M I 2020	6M II 2023	222	222		



4.1.1 c	Aktivitetet ndërgjegjësuese për edukimin ligjor të fëmijëve; Zhvillimi i 10-20 i aktiviteteve sensibilizuese pranë institucioneve arsimore, shëndetësore, vendore, penitenciare, gjyqësore dhe të tjera/viti 2020 *Aktivitetet do të jenë në vijimësi të kohës së zbatimit të këtij plani veprimi		MD	DNJF OSHC	6M II 2020	6M II 2023	4,000		4,000 UNICEF	
4.1.1 ç	Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve për ELP për barazinë gjinore, DHBGJ dhe dhunën në familje, viktimat e veprës penale, viktimat e trafikimit, për fëmijët, për gratë dhe grupet e tjera të cënueshme, me një gjuhë të kuptueshme të përshtatshme për PAK, fëmijët dhe romët e egjiptianët (aktivitetet e parashikuara nga AP fillojnë zbatimin nga 6M II 2020)	96601AA (Kodi i produktit AP)	MSHMS AP	OSHC	6M I 2020	6M II 2022	1,470	270	1,200	
4.1.1 d	Përgatitja e materialeve të thjeshtëzuara e të aksesueshme për PAK në fushën e edukimit ligjor	96601AA	MSHMS	OSHC	6M II 2020	6M II 2023	Kosto administrative			
4.1.1 dh	Përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve për informimin dhe ndërgjegjësimin e fëmijëve/të miturve, për të drejtat dhe mbrojtjes së tyre për fëmijët/të miturit (aktivitetet e parashikuara nga AP fillojnë zbatimin nga 6M II 2020)	96601AA (Kodi i produktit AP)	MB AP	DPPSH	6M I 2020	6M II 2022	50,270	270	50,000	
4.1.1 e	Përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut me fokus dhunën në familje	96601AA	MB	DPPSH	6M II 2020	6M II 2023	70.000		70.000	



4.1.1 ë	Realizimi i materialeve të hartuara, publikuara dhe të shpërndara te qytetarët, institucionet dhe në faqen zyrtare të KDIMDHP/ emisione TV/ botim (revistë periodike) 6-mujore	98901AA	KDIMDP		6M I 2020	6M II 2023	23, 792	23, 792		
4.1.2	Publikimi i materialeve <i>online</i> dhe shpërndarja e tyre në formate të përshtatshme lehtësisht të aksesueshme				2020	2023	475	475		
4.1.2 a	Publikimi i materialeve <i>online</i> në të gjitha faqet e institucioneve të identifikuar dhe në faqen <i>web</i> të Rrjetit/ mediat sociale	91401AA	Ministritë (anëtare të Rrjetit)		6M I 2020	6M II 2023	475	475		
4.1.3	Mekanizma për të përmirësuar bashkëpunimin e vazhdueshëm me median				2020	2023	89	89		
4.1.3 a	Informimi i qytetarëve për iniciativat e reja ligjore dhe ndryshimet e ligjeve në mënyrë të vazhdueshme në formate të thjeshta dhe të kuptueshme për publikun (programe për çështjet parlamentare; video-transmetim i drejtpërdrejtë i seancave parlamentare dhe të komisioneve) *Aktivitete në vijimësi të kohëzbatimit të PV (përgjatë dy 6M)	90202AA	Kuvendi	RTSH OSHC	6M I 2020	6M II 2023	Kosto administrative			
4.1.3 b	Realizimi i programacioneve mediatiqe/ intervistave dhe diskutimeve në TV kombëtare dhe lokale, si dhe në radio nga anëtarët e Rrjetit me tematika të ndryshme ligjore sipas sektorëve përkatës (nr. i programeve RTV me tematika ELP	kodi i produktit DNJF 91406AA;18AR501	DNJF	RTSH OSHC	6M I 2020	6M II 2023	89			



4.2	Objektivi specifik 4.2: Informimi dhe ndërgjegjësimi i gjerë i publikut nëpërmjet fushatave mediatike në një fushë ligjore të caktuar apo në trajtimin ligjor të një fenomeni specifik									
4.2.1	Mekanizma dhe instrumente të lidhura me informimin dhe ndërgjegjësimin publik, të përmirësuara				2020	2023	1,745,804	1,378,637	367,167	
4.2.1 a	Informim i anëtarëve të Kuvendit dhe publikut për çështjet parlamentare (seminare ndërgjegjëse për deputetët/ seminare mbi procesin legjislativ) *Aktiviteti fillon në 6M II 2020 dhe zbatohet përgjatë të dy 6M në vitet e tjerë të PV	90202AA	Kuvendi	OSHC	6M II 2020	6M II 2023	Kosto administrative			
4.2.1 b	Nxjitja e qytetarëve për të qenë pjesëmarrës aktiv në proceset legjislative si Parlament, Qeveri dhe në Njësitë e Qeverisjes vendore Lobimi dhe përfaqësimi i interesave të qytetarëve dhe kategorive në nevojë në çdo iniciativë ligjore në të gjitha nivelet (thirrje për komente/mendime dhe opinione)	90202AA-Kuvendi 91401AA-MD	Kuvendi Ministritë (anëtare të Rrjetit)		6M I 2020	në vazhdim	Kosto administrative			
4.2.1 c	Fushata ndërgjegjëse dhe informuese për ligjin nr.111/2017; broshura dhe fletëpalosje specifike në qytete Tiranë, Durrës, Elbasan, etj) *Aktivitete që kryhen në vijimësi gjatë viteve të zbatimit të PV	kodi i produktit DNJF 91406AA;18AR501	DNJF	OSHC	6M I 2020	6M II 2023	857	857		



4.2.1 ç	Forume të hapura me pjesëmarrje të gjerë qytetare me qëllim marrjen e njohurive ligjore mbi ligjin nr.111/2017, sistemin e ndihmës juridike falas, kushtet/kriteret e përfitimit/subjektet përfitues/shërbimet që ofrohen etj. *Aktivitete që kryhen në vijimësi gjatë viteve të zbatimit të PV	91406AA	DNJF	OSHC	6M I 2020	6M II 2023	178	178		
4.2.1 d	Fushata ndërgjegjëse me institucionet publike/ pushtetin vendor/ dhe komunitetin për pasojat ligjore që kanë personat apo grupe personash që merren me kultivimin e bimëve narkotike, (programi: fushatë ndërgjegjëse për luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike - Kanabissativa)		MB	DPPSH	6M I 2020	6M II 2022	243,942		243,942	
4.2.1 dh	Fushata ndërgjegjëse me institucionet publike/ pushtetin vendor/ dhe komunitetin për pasojat ligjore që kanë personat apo grupe personash që merren me kultivimin e bimëve narkotike, (programi: Zbatimi i Programit ndërgjegjëses në shkolla, “Jo alkoolit, duhani, marijuanës”)		MB	DPPSH	6M I 2020	6M II 2022	Kosto administrative			
4.2.1 e	Fushata ndërgjegjësimi, për të informuar shtetasit shqiptarë për rregullat dhe kushtet e udhëtimit pa vizë në BE, mundësitë e migracionit të rregullt dhe pasojat e migracionit të parregullt (si edhe aplikimeve të pabazuara për azil)	91601AB (Akte ligjore, Auditime të kryera)	MB	DKM; SHKP; MEPJ; MFE; MSHD	6M II 2020	6M II 2022	24,000	24,000		



4.2.1 ë	Fushatë ndërgjegjësuese dhe informuese e komunitetit, të rinjve, nxënësve e mësuesve në shkollë (përfshirë Muajin Antitrafik) lidhur me: legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, kuadrin institucional antitrafikim, format, metodat dhe fenomenin e trafikimit të personave dhe njohja me të drejtat e viktimës	91601AB (Akte ligjore, Auditime të kryera)	MB	MSHMS, KKSAT	6M I 2020	6M II 2020	3, 225		3, 225	
4.2.1 f	Fushata ndërgjegjësuese kombëtare: 12 Prill (dita e FSRR), 12 Qershor (dita kundër punës së fëmijëve) 20 nëntor (dita e të drejtave të fëmijëve) (I) Publikim i shtuar i ngjarjeve informuese me fokus të drejtat dhe mekanizmat institucionalë të mbrojtjes për fëmijët/të miturit (II)	91604AR (Raporte financiare për menaxhimin e burimeve financiare dhe njerëzore)	MB	DPPSH	6M I 2020	6M II 2023	50,000		50,000	
4.2.1 g	Transparencë e shtuar/materiale informuese dhe ndërgjegjësuese me fokus të drejtat dhe mekanizmat e mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje/ takime informuese me grupe të caktuara (vulnerable) me fokus prezantimin e mekanizmave dhe garancive ligjore që ata gëzojnë në kuadër të mbrojtjes nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore	91604AR (Raporte financiare për menaxhimin e burimeve financiare dhe njerëzore)	MB	DPPSH	6M I 2020	6M II 2023	70,000		70,000	
4.2.1 gj	Garantimi i të drejtës për informim mbi fazat e procesit të përzgjedhjes dhe të drejtat e migrantëve, me anë të materialeve të printuara, aplikacioneve në internet dhe shërbimeve të përkthimit, sipas nevojës, në kufi dhe në territor	91604AK (Persona të procesuar në PKK, Kategoria I,II dhe III ajror, tokësor, detar)	MB		6M I 2020	6M II 2022	800,000			
4.2.1 h	Informacion i shtuar në pikat e kalimit kufitar për shkaqet e përfundimit të statusit ligjor, masat kundër qëndrimit të paautorizuar dhe të drejtat procedurale të subjekteve të hetimit	91604AK (Persona të procesuar në PKK, Kategoria I,II dhe III ajror, tokësor, detar)	MB	DPPSH	6M I 2020	6M II 2022	552,000			



4.2.1 i	Informimi i komunitetit, të rinjve, të miturve (kryesisht nxënës të shkollave të mesme) mbi përgjegjësinë penale, për veprat penale (krime/kundërvajtje) kundër jetës, shëndetit dhe integritetit të personit (gender).	91604AR (Raporte financiare për menaxhimin e burimeve financiare dhe njerëzore)	MB	DPPSH	6M I 2020	6M II 2022	Kosto administrative			
4.2.1.j	Dizenjimi i një fushate sensibilizimi për njohjen e publikut të gjerë me kuadrin ligjor për transmetimet TV (Kodi i transmetimit dhe përmbajtjes audiovizive); Aktivitete për njohjen e publikut me pjesë të veçanta të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar/ Kodi i Transmetimit	Zëri i shpenzimeve - 6029	AMA		6M I 2022	6M II 2022	682	682		
4.2.1.k	Zhvillimi i trajnimeve me autoritetet publike dhe/ose kontrollues/përpunues në kuadër të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale	98901AA	KDIMDP	MASR IAL	6M II 2020	6M II 2020	1, 920	1, 920		
4.3	Objektivi specifik 4.3: Rritja e kapaciteteve të individëve në ushtrimin e të drejtave të tyre, në aftësinë për të kuptuar dhe marrë vendimet e duhura									
4.3.1	Raport vlerësimi mbi nevojat e qytetarëve për modele të gatshme vetëpërfaqësimi				2020	2020	1,069	1,069		
4.3.1 a	Raport vlerësimi mbi situatën aktuale dhe statistikat mbi vetëpërfaqësimin ligjor dhe modelat aktuale që përdoren, i hartuar	91401AA	MD	Ministritë (anëtarë të Rrjetit) OSHC	6M II 2021	6M II 2021	1,069	1,069		
4.3.2	Modelet e gatshme për vetëpërfaqësim në institucione të hartuara dhe publikuara				2020	2023	600	600		



4.3.2 a	Hartimi dhe përditësimi i modeleve të vetëpërfaqësimit për qytetarët nga institucionet përkatëse, (përgjatë viteve 2021/2022/2023)	91401AA	Ministritë (anëtarë të Rrjetit)	OSHC	6M II 2021	6M II 2023	600	600		
4.4	Objektivi specifik 4.4: Garantimi i informacionit ligjor në kohë reale dhe sa më pranë komunitetit									
4.4.1	Krijimi i kanaleve të komunikimit dhe informimit ligjor të qytetarëve për ELP-të				2020	2023	21,268	10, 068		11,200
4.4.1 a	Linjat telefonike “ <i>help line</i> ” që ofrojnë informacione rreth aspekteve të ligjit të krijuara në 12 NJQV (I) Hartimi dhe miratimi i rregullores tip për funksionimin e linjave telefonike “ <i>help line</i> ” (II) Përcaktimi dhe/ose përfshirja në strukturën e bashkive të punonjësve që do të ofrojnë shërbimet “ <i>help line</i> ” (III)	91602AC (Aktivitetet për bashkërendim procesesh mes bashkive)	NJQV (Berat Dibër Durrës Elbasan Fier Gjirokastër Tiranë Korçë Kukës Lezhë Shkodër Vlorë)	OSHC	6M II 2022	6 M II 2022	11,200			11,200
4.4.1 b	Ngritja dhe funksionimi i linjave “ <i>help line</i> ”: linja e këshillimit për gra dhe vajza 116 117, linja e këshillimit për fëmijët ALO 116 111, si dhe strehëza LGBTI	91307 AH	MSHMS	OSHC	6M I 2020	6M II 2020	10, 068	10, 068		
4.4.1.c	Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të institucioneve të linjës për edukimin ligjor të aksesueshëm për të gjitha kategoritë PAK	96601AA	MSHMS	OSHC	6M I 2020	6M II 2020	Kosto administrative			
4.5	Objektivi specifik 4.5: Nxitja e aktivizimit të publikut përmes informimit mbi përgjegjësitë e institucioneve dhe mënyrat e pjesëmarrjes në vendimmarrje									
4.5.1	Ditët e Hapura pranë Bashkive/forume me qytetarë				2020	2023	26,962		20,125	2, 896



4.5.1 a	Hartimi i kalendarit të ditëve të hapura për çdo Bashki dhe Njësi Administrative (I) Përgatitja e materialeve të nevojshme për Ditën e Hapur (II) Zhvillimi i Ditëve të Hapura (disa ditë të hapura/vit) - (III)	96601AA	AP	NJQV OSHC	6M II 2020	6M II 2023	959	959		
4.5.1.b	Veprimtari promovuese për të drejtat e njeriut (përfshirë çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve/ mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna/ aktivitetet me fëmijë dhe familje nga komunitete të ndryshme (aktivitetet e parashikuara nga AP fillojnë zbatimin nga 6M II 2020)	96601AA (kodi i produktit AP)	AP KMD	NJQV OSHC	6M II 2020	6M II 2023	1,002	502	500 UNICEF	
4.5.1.c	Zhvillimi i Ditëve të Hapura për të drejtën e informimit	98901AA	KDIMDP	NJQV OSHC org. ndërkomb.	6M II 2020	6M II 2020	5, 376	2, 480		2, 896
4.5.1 ç	Ditët e Hapura (disa ditë/vit) pranë Bashkive/forume me qytetarë për t'u njohur me punën e institucioneve dhe shërbimet që ofrohen në nivel lokal të zhvilluara (çështje të dhunës/mbrojtjes së fëmijëve)	91602AC (Aktivitet për bashkërendim procesesh mes bashkive)	MB/AMVV	OSHC	6M II 2020	6M II 2020	Kosto administrative			
4.5.1 d	Ndërtimi i faqeve të internetit për 48 bashki dhe formatimi i tyre në një format lehtësisht të aksesueshëm për qytetarin duke ndikuar edhe në edukimin ligjor të tyre	91602AC (Aktivitet për bashkërendim procesesh mes bashkive)	MB/AMVV	NJQV	6M II 2020	Në vijim	3, 625		3,625 STAR 2	
4.5.1 dh	Qytetarë të informuar mbi bashkitë, mbi akte dhe dokumente informative dhe pjesëmarrje aktive në vendimmarrje (dokument miqësor “Plan dhe raport performance për aprovimin dhe monitorimin e parave lidhur me rezultatet”	91602AC (Aktivitet për bashkërendim procesesh mes bashkive)	MB/AMVV NJQV		6M II 2020	Në vijim	16, 000		16,000 Bashkitë e Forta Helvetas	



4.6	Objektivi specifik 4.6: Rritja e pjesëmarrjes dhe rolit të studentëve të drejtësisë dhe profesionistëve të së drejtës në ELP									
4.6.1	Qytetarët të informuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore, nëpërmjet aktiviteteve me studentë të ligjit dhe avokatë të specializuar				2020	2023	7,513	7,513		0
4.6.1 a	Aktivitetet të zhvilluara me studentë të shkencave të komunikimit për të ofruar ELP pranë komuniteteve	91401AA (MD) 91105AA(MASR)	MD DNJF MASR	OSHC IAL	6M II 2020	6M II 2023	713	713		
4.6.1.b	Organizimi i Shkollës Verore “Informim dhe Privatësi” me Universitete në rrethet e ndryshme të vendit *Aktivitetet i organizuar 6M I/çdo vit	98901AA	KDIMDP	IAL	6M I 2020	6M I 2023	3, 200	3, 200		
4.7	Objektivi specifik 4.7: Përmirësimi i programit të edukimit ligjor në lëndët bazë të arsimit parauniversitar dhe pasurimi i kurrikulave e aktiviteteve ekstrakurrikulare me elemente të edukimit ligjor									
4.7.1	Rishikimi i programeve të trajnimit të mësuesve duke integruar specifikisht elemente të edukimit ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve				2020	2023	520		520	
4.7.1 a	Ngritja e grupit të punës me ekspertë të arsimit dhe të fushës ligjore për rishikimin e programeve të trajnimit të mësuesve	911003AF	MASR/ASCAP	OSHC	6M II 2020	6M II 2020	320		320 UNICEF	
4.7.1 b	Identifikimi i elementeve të edukimit ligjor që do të përshtaten dhe përfshihen në programet e trajnimit të mësuesve	911003AF	MASR		6M II 2020	6M II 2020	Kosto administrative			



4.7.1 c	Përditësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i moduleve të trajnimit të mësuesve që ofrohen nga organizata të interesuara në fushën e edukimit ligjor	911003AF	MASR, ASCAP, AShMDF	OSHC	6M I 2023	6M II 2023	200		200 UNICEF	
4.7.2	Kapacitete të përmirësuara të stafit arsimor për EL të fëmijëve dhe fuqizimi i tyre nëpërmjet informimit mbi të drejtat e tyre dhe strukturat mbrojtëse				2020	2021	11,000	11,000		
4.7.2 a	Ngritja dhe forcimi kapaciteteve për të zhvilluar të mësuesit, punonjësit psikosocial, oficerët e sigurisë kompetencën lidhur me edukimin për qytetari demokratike dhe edukimin për të drejtat e njeriut	91104AC	MASR/ASCAP AShMDF	OSHC	6M I 2021	6M II 2021	10,800	10,800		
4.7.2.b	Përmirësim të kapaciteteve të mësuesve të arsimit parauniversitar nga specialistë të fushës së edukimit ligjor dhe të drejtat e fëmijëve	91104AC	MASR/DPAP	OSHC	6M I 2021	6M II 2023	200	200		
4.7.2.c	Ngritja e kapaciteteve të stafit arsimor (mësues/edukatorë/ punonjës socialë/psikolog) mbi kompetencën mbi edukimin ligjor për fëmijët me AK	91104 AC	MASR	OSHC	6M I 2021	6M II 2023	Kosto administrative			
4.7.3	Aktivitetet informuese dhe edukuese në institucionet e arsimit parauniversitar të zhvilluara				2020	2023	6,715		3, 700	



4.7.3 a	Hartimi i planit të aktiviteteve vjetore të ELP në institucionet e arsimit parauniversitar (I) Miratimi nga DAR i planeve të aktiviteteve vjetore për ELP në institucionet e arsimit parauniversitar- viti 2020 (II) Zhvillimi i aktiviteteve sipas planit të miratuar dhe Realizimi i orëve të hapura me klasat e arsimit parauniversitar; botimi i materialeve informuese, nga AP - viti 2021/2022 (III) Konferencë për të drejtat e fëmijëve nga AP - viti 2021 (aktivitetet e parashikuara nga AP fillojnë zbatimin nga 6M II 2020)	911003AF 96601AA (kodi i produktit AP)	MASR/DRAP-ZVAP AP	OSHC	6M I 2021	6M II 2023	795	795		
4.7.3 b	Materiale informuese dhe ndërgjegjësim për çështje specifike (dhuna në familje/dhuna me bazë gjinore/etj), të përgatitura dhe të shpërndara në institucionet e arsimit parauniversitar, mësuesve dhe nxënësve	91103AB	MASR/DPAP	OSHC	6M II 2020	6M II 2023	200	200		
4.7.3 c	Fushata ndërgjegjësuere me lojën “Luaj dhe mëso – <i>Happy Onljë</i> ” për nxënësit e shkollave 9-vjeçare *Aktiviteti i organizuar 6M I/çdo vit	98901AA	KDIMDP	DRAP-ZVAP OSHC	6M I 2021	6M I 2023	5, 720	2, 020	3, 700	



VENDIM

Nr. 879, datë 11.11.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 5, DATË 6.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR PËRFITIMET NGA PROGRAMI I GRANTEVE TË RINDËRTIMIT DHE PROJEKTET MODEL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18, 19, 20 e 25, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 8, e kreut II, të vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Projekt model konsiderohet edhe:

a) projekti që realizon vetë subjekti, që kërkon përfitimin e grantit, me kusht që të plotësojë kërkesat dhe standardet sipas parimeve të procesit të rindërtimit dhe sipas parashikimeve të këtij vendimi;

b) projekti që realizon vetë subjekti, kur ndërtimi do të realizohet në të njëjtin truall dhe sipërfaqja e truallit nuk lejon realizimin e projektit model, me kusht që të plotësojë kërkesat dhe standardet sipas parimeve të procesit të rindërtimit dhe sipas parashikimeve të këtij vendimi.

Vlera e grantit që përfitohet, edhe në këto raste, përlogaritet sipas parashikimeve të kreut III, të këtij vendimi, dhe miratohet me vendim të këshillit bashkiak të njësive të vetëqeverisjes vendore.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Rindërtimin, Enti Kombëtar i Banesave dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 880, datë 11.11.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË BANESAVE INDIVIDUALE DHE TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË DURRËS, LEZHË DHE KAMZË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nëndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 318 330 000 (treqind e tetëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë mijë) lekë, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, në bashkitë Durrës, Lezhë e Kamzë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, dhe t’u kalojë bashkive Durrës, Lezhë dhe Kamzë, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, përkatësisht, si më poshtë vijon:



a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi prej 63 250 000 (gjashtëdhjetë e tre milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh;

b) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi prej 78 750 000 (shtatëdhjetë e tetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh;

c) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi prej 176 330 000 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e treqind e tridhjetë mijë) lekësh.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Durrës, Lezhë e Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 881, datë 28.10.2020

PËR DHËNIEN E STATUSIT TË
VEÇANTË AKADEMISË SË SIGURISË,
SI INSTITUCIONI I VETËM PUBLIK I
ARSIMIT TË LARTË NË FUSHËN E
RENDIT E TË SIGURISË PUBLIKE,
SI DHE ORGANIZIMIN E
FUNKSIONIMIT E SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 5, të nenit 37, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Akademia e Sigurisë, në vijim “AS”, është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, së cilës i jepet status i veçantë dhe ka varësi nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe ministri përgjegjës për arsimin.

2. Statusi i veçantë i AS-së konsiston në organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e procesit

mësimor, trajtimin specifik të organizimit akademik dhe administrativ, të personelit akademik, të personelit ndihmësakademik, trajnues dhe administrativ, të programeve të studimit, të kualifikimit, të trajnimit e të stërvitjes, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi.

3. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike përcakton politikat e arsimit e të kualifikimit në fushën e rendit e të sigurisë publike, në përputhje me nevojat e Policisë së Shtetit dhe të institucioneve të tjera të sigurisë në vend.

4. AS-ja ofron programe për formimin, specializimin, kualifikimin dhe trajnimin, në të gjitha nivelet, të punonjësve në uniformë e civilë të institucioneve, si:

- a) Policia e Shtetit;
- b) Garda e Republikës;
- c) Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve;
- ç) Shërbimi i Provës;
- d) Shërbimi i çështjeve të brendshme në Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë;
- dh) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- e) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- ë) Policia Bashkiake;
- f) Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin;
- g) Persona fizikë e juridikë, që ofrojnë shërbimin e sigurisë fizike, subjekt të së drejtës private apo publike;

gj) Institucione të tjera, pavarësisht emërimit, të krijuara me akte të tjera që operojnë në fushën e rendit dhe të sigurisë publike.

5. Organizimi i AS-së është, si më poshtë vijon:

- a) Senati Akademik;
- b) Rektori;
- c) Rektorati;
- ç) Dekani;
- d) Dekanati;
- dh) Asambleja e personelit akademik;
- e) Drejtuesit e njësive bazë;
- ë) Komisionet e përhershme;
- f) Bordi këshillues;
- g) Bordi i administrimit;
- gj) Administratori i institucionit.

6. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të organeve kolegjiale dhe e autoriteteve drejtuese, përbërja e bordit të administrimit, si dhe kompetencat e administratorit të AS-së



parashikohen në statutin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë.

7. Rektori i AS-së dekretohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e rendit e të sigurisë publike dhe të ministrit përgjegjës për arsimin.

8. Pranë AS-së krijohet Bordi Këshillues, si organ kolegial këshillimor për çështjet e zhvillimit institucional të Akademisë, për planifikimin/koordinimin e kuotave dhe kapaciteteve, profilet akademike dhe çështje të tjera të veprimtarisë së Akademisë me institucionet përfituese. Mënyra e organizimit dhe e përzgjedhjes së anëtarëve dhe funksionet e tjera të Bordit Këshillues të AS-së përcaktohen në statut, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi dhe të kuadrit ligjor në fuqi.

9. Akademia e Sigurisë organizon programe studimi të arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike në të gjitha ciklet, kurse profesionale të formimit bazë dhe të kualifikimit të vazhduar për çdo gradë, kurse specializimi për çdo shërbim e profil dhe trajnim praktik për punonjësit e strukturave, të përmendura në pikën 4, të këtij vendimi.

10. Njësitë kryesore përbërëse të Akademisë së Sigurisë janë:

- a) Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit;
- b) Kolegji Profesional i Formimit Policor.

11. Personeli, i cili rekrutohet në institucionet e përcaktuara në pikën 4, dhe personeli që konkurren për gradën pasardhëse dhe funksione më të larta në këto institucione u nënshtrohen programeve të formimit/kualifikimit përkatës në AS, sipas përcaktimeve në strategjinë e formimit në fushën e rendit e të sigurisë publike për këto institucione.

12. AS-ja ofron, gjithashtu:

a) zhvillimin e kërkimeve dhe të studimeve shkencore në fushën e policimit dhe të sigurisë;

b) dhënien e ekspertizës për leadershipin e lartë civil e atë profesional në hartimin dhe formulimin e dokumenteve kryesore strategjike në fushën e rendit e të sigurisë publike, zhvillimin dhe përdorimin e kapaciteteve në këtë fushë;

c) realizimin e shërbimeve mbështetëse për nevojat e trajnimit dhe të formimit: si trajtimin me ushqim, akomodim etj. të studentëve dhe të kursantëve përfitues;

ç) administrimin e të dhënave për të gjitha programet dhe trajnimet që zhvillohen në Akademi;

d) koordinimin periodik me institucionet e sigurisë mbi nevojat e planifikimit të trajnimeve/shkollimeve dhe kuotave për formimin dhe trajnimin e punonjësve të këtyre institucioneve.

13. AS-ja, për përmbushjen e përgjegjësi të saj, bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, organizmat ndërkombëtarë, institucionet homologe të huaja, si dhe organizatat joqeveritare me rol të rëndësishëm në fushën e rendit e të sigurisë publike.

14. Personeli i Akademisë së Sigurisë përbëhet nga: personel akademik, personel ndihmës-akademik, personel trajnues dhe personel administrativ.

15. Personeli akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë dhe personeli akademik me kohë të pjesshme në cilësinë e ekspertëve të fushave përkatëse. Punësimi i personelit bëhet në përputhje me dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi, rregullat e përcaktuara në statutin e Akademisë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit midis titullarit të Akademisë së Sigurisë dhe titullarit të institucionit përfitues.

16. Personeli akademik, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në: profesorë, lektorë, asistent-lektorë.

17. Në mungesë të personelit akademik dhe vetëm pasi nga ana e AS-së janë bërë 2 shpallje publike të njëpasnjëshme për plotësimin e vendeve vakante në pozicionet akademike me anë të konkurrimit dhe kanë rezultuar të pasuksesshme për përzgjedhjen e personelit akademik, plotësimi i këtyre vendeve bëhet me personel nga Policia e Shtetit dhe institucionet përfituese. Për këtë kategori të personelit, për kohën që janë pjesë e strukturave mësimdhënëse në Akademinë e Sigurisë dhe vetëm për efekt të veprimtarisë akademike, bëhet njësimi i gradave policore apo edhe i gradave të institucioneve të tjera me titujt dhe gradat e personelit/funksionit akademik.

18. Njësimi me titujt akademikë dhe gradat shkencore, vetëm për efekt të veprimtarisë akademike në Akademi, pa gëzuar të drejta të tjera, është si më poshtë vijon:

a) Për personelin akademik të kategorisë “Profesor”, grada policore “Drejtues i lartë”/ “Drejtues i parë” është ekuivalente me titujt akademikë “Profesor” ose “Profesor i asociuar”;

b) Për personelin akademik të kategorisë “Lektor”, grada policore “Drejtues”/



“Kryekomisar” është ekuivalente me gradën shkencore “Doktor”;

c) Për personelin akademik të kategorisë “Asistent–Lëktor”, grada policore “Komisar”/ “Nënkomisar” është ekuivalente me “Master i shkencave”.

19. Punësimi i personelit të Akademisë, sipas kategorive përkatëse, bëhet në përputhje me dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi, rregullat e përcaktuara në statutin e Akademisë, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit midis titullarit të AS-së dhe titullarit të institucionit përfitues. Personeli i punësuar sipas kësaj pike, për periudhën që punon në Akademi, ruan statusin në institucionet respektive.

20. Në strukturat dhe njësitë përbërëse të Akademisë së Sigurisë, funksionet organike cilësohen në bazë të specialitetit dhe të institucionit përfitues, të përmendura në pikën 4, të këtij vendimi. Institucionet përfituese janë përgjegjëse për plotësimin me personel të këtyre funksioneve.

21. Pranimi i kandidatëve për kursantë në Akademi kryhet sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin sektorial të institucioneve përfituese.

22. Kuotat e pranimit të kandidatëve për studentë, për çdo program studimi, shqyrtohen në bazë të nevojës së institucioneve të interesuara dhe kapaciteteve të Akademisë nga Bordi Këshillues i Akademisë së Sigurisë, miratohen nga Senati Akademik i Akademisë dhe paraqiten për certifikim në ministrinë përgjegjëse për arsimin, sipas legjislacionit në fuqi.

23. Kuotat e pranimit të kursantëve për programet e trajnimit dhe specializimeve shqyrtohen mbi bazën e nevojës së institucioneve të interesuara dhe kapaciteteve të Akademisë nga Bordi Këshillues i AS-së dhe miratohen me vendim të Senatit të Akademik.

24. Akademia përgatit planin periodik për studime, specializime, kualifikime dhe trajnime në bashkëpunim me institucionet e interesuara. Procedurat e planifikimit për studime, specializime, kualifikime dhe trajnime miratohen nga Senati Akademik, me propozim të Bordit Këshillues të Akademisë së Sigurisë.

25. Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e programeve të studimit miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar statusin e veçantë të Akademisë së Sigurisë.

26. Akreditimi institucional i Akademisë së Sigurisë dhe i programeve të studimit bëhet nga struktura përgjegjëse, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar statusin e veçantë të Akademisë së Sigurisë.

27. Ekuivalentimi/njëvlershmëria e programeve të studimit dhe e kualifikimeve të kryera në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit, në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, rregullohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe të ministrit përgjegjës për arsimin.

28. Statuti i Akademisë miratohet nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe ministri përgjegjës për arsimin.

29. Akademia financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme. Programi buxhetor i Akademisë është pjesë e programit buxhetor të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

30. Struktura dhe organika e Akademisë së Sigurisë miratohen para fillimit të vitit akademik, me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përcaktimet në statut dhe nuk mund të ndryshohet pa përfunduar viti akademik.

31. Me miratimin e strukturës së re organike, në zbatim të këtij vendimi, Akademia e Sigurisë bën shpalljen publike për plotësimin e pozicioneve akademike me konkurs, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, sipas legjislacionit në fuqi.

32. Vendimi nr. 185, datë 25.2.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”, shfuqizohet.

33. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



UDHËZIM

Nr. 443, datë 4.11.2020

**PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË
KËRKESËS, DOKUMENTACIONIT
SHOQËRUES DHE PROCEDURËS SË
SHQYRTIMIT TË DOKUMENTACIONIT
NGA ANA E SEKRETARIATIT TEKNIK
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
MUZEVE, PËR KRIJIMIN E MUZEVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 1, të nenit 215, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”,

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim përcakton:

- a) formatin e kërkesës për krijimin e muzeut;
- b) dokumentacionin shoqërues të kërkesës;
- c) procedurën e shqyrtimit të dokumentacionit nga ana e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Muzeve (KKM).

2. Ky udhëzim zbatohet për krijimin e muzeve, si më poshtë:

- a) Muze qendror;
- b) Muze vendor;
- c) Muze autonom;
- ç) Muze privat.

II. KËRKESA PËR KRIJIMIN E NJË MUZEU

1. Çdo institucion qendror ose vendor, si dhe çdo person fizik apo juridik i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për veprimtaritë tregtare, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për krijimin e një muzeu sipas parashikimeve të nenit 214 dhe 215, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

2. Aplikimi bëhet sipas formatit të kërkesës në aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

III. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

1. Dokumentacioni i administruar pranë Sekretarisë Teknike të KKM-së, me qëllim marrjen e vendimit paraprak për krijimin e një muzeu, duhet të përmbajë:

a) iniciativën për krijimin e muzeut. Iniciativa për krijimin e muzeut merret:

i. nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në rastin e krijimit të muzeut qendror;

ii. nga Këshilli Bashkiak, me propozim të kryetarit të njësive së vetëqeverisjes vendore, në rastin e krijimit të muzeut vendor;

iii. nga titullari i institucionit publik, ose organi vendimmarrës i personit juridik publik qendror ose vendor me kapital shtetëror, apo ndonjë person juridik privat, por që pjesëmarrës ose themelues ka një person juridik publik;

iv. nga personi fizik ose nga organi vendimmarrës i personit juridik, që është pronarë ose posedues i koleksioneve muzeore;

b) autorizim lidhur me përfaqësuesin për ndjekjen e projektit nga subjekti aplikues;

c) kopje të dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit të autorizuar nga subjekti aplikues;

ç) NIPT/NUIS;

d) vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore, taksave deri në momentin e paraqitjes së kërkesës (nga bashkia ku ushtron aktivitetin kryesor subjekti dhe Drejtoria Tatimore), kur aplikuesi është subjekt privat;

dh) listën e objekteve muzeore, koleksioneve në pronësi ose posedim të aplikuesit, të shoqëruara me dokumentacionet përkatëse të lëshuara nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK);

e) Projektidenë e muzealizimit; (Planvendosje e godinës së muzeut; përshkrim narrativ i tematikës/kronologjisë që përfaqëson muzeu; projekti teknik për infrastrukturën e muzeut);

ë) relacion shoqërues të projektit;

f) prezantim në *Power Point*;

g) dokumente që pasqyrojnë statusin e pronës që do të përdoret si muze, si dhe një organigramë të burimeve njerëzore që do të përdoren për administrimin e muzeut;

gj) CD-Room me të gjitha dokumentet e sipërcituara.

2. Në rastin kur vendimi paraprak për krijimin e një muzeu është pozitiv, KKM-ja kërkon edhe:

a) afatin, brenda të cilit kërkuesi duhet të provojë krijimin e muzeut si një organizatë jofitimprurëse;

b) kushte të tjera që vlerëson të nevojshme për të provuar krijimin e muzeut, kur është rasti.



IV. PROCEDURA E SHQYRTIMIT TË DOKUMENTACIONIT

1. Kërkesa, bashkë me dokumentacionin shoqërues, paraqitet pranë Muzeut Historik Kombëtar (MHK), në cilësinë e Sekretariatit Teknik të KKM-së, me qëllim marrjen e vendimit paraprak për krijimin e një muzeu.

2. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit nga ana e Sekretarisë Teknike realizohet, si më poshtë:

a) Sekretaria Teknike merr në shqyrtim dosjet e përcjella, sipas radhës së paraqitjes së tyre, dhe verifikon nëse aplikimi dhe dokumentacioni i përcjellë është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë udhëzim, brenda 5 ditëve nga marrja e aplikimit.

b) Nëse aplikimi përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e parashikuar në këtë udhëzim, Sekretaria Teknike ia përcjell dosjen për shqyrtim të mëtejshëm dhe komente sektorëve të përmbajtjes në MHK dhe më pas harton relacionin përkatës lidhur me vlerësimin e dosjes brenda 10 ditëve.

c) Nëse aplikimi ka mungesë dokumentacioni të parashikuar në këtë udhëzim, Sekretaria Teknike njofton aplikuesin të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm brenda 20 ditëve. Nëse aplikuesi nuk i

plotëson mangësitë në dokumentacion brenda afatit të caktuar, e kthen dosjen “pa veprim”.

ç) Sekretaria Teknike i përcjell anëtarëve të KKM-së njoftimin mbi organizimin e mbledhjes, të caktuar nga kryetari, relacionin e dosjes së aplikimit/kërkesës së subjektit dhe rendin e ditës, të paktën 48 orë përpara zhvillimit të mbledhjes.

V. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Të gjitha kërkesat për krijimin e muzeve dhe dokumentacioni shoqërues do të dërgohen në formë fizike, nëpërmjet shërbimit postar, pranë Sekretarisë Teknike të KKM-së, deri në kalimin e të gjithë procedurës në sistemin elektronik, për aplikimin *online* në portalin *e-Albania*.

2. Të gjithë subjektet të cilët kanë paraqitur kërkesat për krijimin e muzeve dhe nuk janë shqyrtuar nga KKM-ja përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Ngarkohet Sekretaria Teknike e KKM-së për zbatimin e këtij udhëzimi.

4. Çdo akt nënligjor ose rregullore që bie në kundërshtim me këtë udhëzim shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti

ANEKS 1 FORMULAR KËRKESE PËR KRIJIMIN E NJË MUZEU

1. TË DHËNA PËR KËRKUESIN	
Emri i subjektit kërkuar:	
Adresa e subjektit:	
Statusi i subjektit:	☐ Institucion publik qendror ☐ Institucion publik vendor ☐ Person fizik ☐ Person juridik
NIPT:	
Përfaqësuesi i autorizuar në ndjekjen e projektit:	(Emri, mbiemri, ID, Nr., Tel. / Cel., Email)
2. KLASIFIKIMI I MUZEUT SIPAS KËRKESES	
Klasifikimi sipas	☐ Muze qendror (propozues Ministria e Kulturës)



propozuesit:	Muze vendor	(propozues njësia e vetëqeverisjes vendore)
	Muze autonom institucion publik	(propozues institucion publik i ndryshëm nga lart përmendur)
	Muze autonom person juridik privat	(propozues person juridik publik me kapital shtetëror dhe person juridik privat me pjesëmarrës person juridik publik)
	Muze privat	(propozues person fizik ose juridik privat)
Klasifikimi sipas tematikës:	Muze i përgjithshëm	
	Muze i specializuar _____	(specifiko tematikën)
Klasifikimi sipas pronësisë së fondeve:	Muze publik	(për muzetë qendror, vendor dhe muzetë autonom - institucion publik)
	Muze privat	(për muzetë privat dhe autonom – person juridik privat)
Statusi:	Me status kombëtar	(vetëm për muzetë qendror dhe privat)
	Pa status kombëtar	
3. TË DHËNA PËR INFRASTRUKTURËN E MUZEUT		
Adresa:		
Nr. kate:		
Sipërfaqja totale:		
4. ADMINISTRIMI I PARASHIKUAR		
Përshkrim mbi sigurimin e qëndrueshmërisë së muzeut, si: - administrimin e muzeut - burimet njerëzore - burimet financiare		
5. TË DHËNA MBI FONDIN MUZEOR		
Nr. i objekteve muzeore:		
Tipologjia e objekteve muzeore:		
Origjina e objekteve:		
6. TË DHËNA MBI PROJEKTIDENË (deri në 4 paragrafë)		
Përshkrimi narrativ i linjës muzeore:		
Mënyra dhe forma e ekspozimit:	(Përshkrim mbi ekspozitën e përbërshme dhe të përkohshme ndërthurur me ndarjen funksionale të godinës; detaje mbi formën e ekspozimit tradicional me ekspozitor, virtual, etj.)	
Ndërhyrjet e parashikuara për infrastrukturën e muzeut:	(Listimi i ndërhyrjeve kryesore që parashikohen si: ndërtim i ri, rikonstruksion, përshtatje, etj.)	



7. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

1. Iniciativa për krijimin e muzeut
(- në rastin e muzeut qendror, dokumentin zyrtar të miratimit nga titullari institucionit;
- në rastin e muzeut vendor, vendimin e Këshillit Bashkiak;
- në rastin e muzeut autonom, dokumentin zyrtar të miratimit nga titullari institucionit apo organet vendimmarrëse ose personi juridik publik me kapital shtetëror;
- në rastin e muzeut privat, dokumentin zyrtar të miratimit nga personi fizik ose juridik)
2. Autorizimi nga titullari lidhur me përfaqësuesin për ndjekjen e projektit nga subjekti propozues
3. Kopje të dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit të autorizuar
4. NIPT/NUIS
5. Listën e objekteve muzeore, koleksioneve të shoqëruara me dokumentacionet përkatëse të lëshuara nga IKRTK-ja
6. Projektideja e muzealizimit
(Planvendosje e godinës së muzeut; përshkrim narrativ i tematikës/kronologjisë që përfaqëson muzeun; projekti teknik për infrastrukturën e muzeut)
7. Relacion shoqërues i projektit
8. Prezantimi në Power Point
9. Dokumente që pasqyrojnë statusin e pronës që do të përdoret si muze, si dhe një organigramë të burimeve njerëzore që do të përdoren për administrimin e muzeut
10. CD-Room me të gjithë dokumentet e sipërcituar

8. DOKUMENTACIONET/VERIFIKIMET/MIRATIMET QË SIGUROHEN NGA BASHKËVEPRIMI NDËRINSTITUCIONAL

Certifikata e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit

Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore, taksave deri në momentin e paraqitjes së kërkesës (nga bashkia ku ushtron aktivitetin kryesor subjekti dhe Drejtoria Tatimore), kur aplikuesi është subjekt privat

9. NJOFTIMI

Marra e informacionit:	Postë	Email	E-Albania
Email (për njoftimin):			
Afati i njoftimit:	Jo më vonë se 3 ditë nga vendimi i KKM-së		

Ky shërbim jepet bazuar në:

1. Ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;
2. VKM-në nr.788, datë 26.12.2018, “Për përbërjen, kompetencat, mënyrën e funksionimit e të shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Muzeve”;
3. Urdhrin nr. ___, datë _____ të Ministrit të Kulturës “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Muzeve dhe Sekretarisë Teknike”;
4. Udhëzimin nr. ___, datë _____ të Ministrit të Kulturës “Për miratimin e formatit të kërkesës, dokumentacionit shoqërues dhe procedurën e shqyrtimit të dokumentacionit nga ana e Sekretarisë Teknike të Këshillit Kombëtar të Muzeve për krijimin e muzeve”.



URDHËR

Nr. 334, datë 10.11.2020

**PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT
ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PUBLIK
TË ARSIMIT PARASHKOLLOR,
KOPSHTI NË FSHATIN LOSNIK,
NJËSIA ADMINISTRATIVE VELÇAN,
BASHKIA POGRADec**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të kreut I/A, të vendimit nr. 662, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike”,

KONSTATOJ:

Këshilli Bashkiak Pogradec, me vendimin nr. 6, datë 28.1.2020, “Propozim për hapjen dhe funksionimin e institucionit arsimor publik, parashkollor, kopsht, në fshatin Losnik, Njësia Administrative Velçan”, në zbatim të vendimit nr. 662, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, në bashkëpunim me Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Pogradec, pas konsultimit me përfaqësues të komunitetit të zonës, kanë paraqitur kërkesën e argumentuar, për hapjen e institucionit arsimor publik, parashkollor, kopshti në fshatin Losnik.

Bashkia Pogradec merr përsipër trajtimin me pagë të punonjësit arsimor parashkollor, sipas vendimit nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1, të nenit 41, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen e institucionit arsimor parauniversitar publik, të arsimit parashkollor, kopshti në fshatin Losnik, Njësia Administrative Velçan, Bashkia Pogradec.

2. Bashkia Pogradec të sigurojë ambientet dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së kopshtit, në bazë të legjislacionit në fuqi.

3. Bashkia Pogradec të realizojë procedurat për emërimin e stafit të kopshtit, bazuar në normat e punës mësimore, të përcaktuar në udhëzimin nr. 30, datë 12.9.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.

4. Kopshti duhet të ketë në ruajtje dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentacionin themeltar në ruajtje të përhershme, si: regjistër amze, indeks alfabetik, regjistër të veçantë, statistika vjetore të numrit të fëmijëve dhe të mësuesve;

b) regjistra të përkohshëm, si: regjistra klase;

c) rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit.

5. Institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit do të hapet kopshti i fshatit Losnik, të monitorojë veprimtarinë mësimdhënëse të këtij institucioni arsimor parauniversitar publik, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe Bashkia Pogradec.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi



URDHËR

Nr. 335, datë 10.11.2020

**PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT
ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PUBLIK
TË ARSIMIT PARASHKOLLOR,
KOPSHTI NË FSHATIN HOMÇAN,
NJËSIA ADMINISTRATIVE PROPTISHT,
BASHKIA POGRADEDEC**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të kreut I/A, të vendimit nr. 662, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike”,

KONSTATOJ:

Këshilli Bashkiak Pogradec, me vendimin nr. 5, datë 28.1.2020, “Propozim për hapjen dhe funksionimin e institucionit arsimor publik, parashkollor, kopsht, në fshatin Homçan, Njësia Administrative Proptisht”, në zbatim të vendimit nr. 662, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, në bashkëpunim me Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Pogradec, pas konsultimit me përfaqësues të komunitetit të zonës, kanë paraqitur kërkesën e argumentuar, për hapjen e institucionit arsimor publik, parashkollor, kopshti në fshatin Homçan.

Bashkia Pogradec merr përsipër trajtimin me pagë të punonjësit arsimor parashkollor, sipas vendimit nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1, të nenit 41, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen e institucionit arsimor parauniversitar publik, të arsimit parashkollor, kopshti në fshatin Homçan, Njësia Administrative Proptisht, Bashkia Pogradec.

2. Bashkia Pogradec të sigurojë ambientet dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së kopshtit, në bazë të legjislacionit në fuqi.

3. Bashkia Pogradec të realizojë procedurat për emërimin e stafit të kopshtit, bazuar në normat e punës mësimore, të përcaktuar në udhëzimin nr. 30, datë 12.9.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.

4. Kopshti duhet të ketë në ruajtje dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentacionin themeltar në ruajtje të përhershme, si: regjistër amze, indeks alfabetik, regjistër të veçantë, statistika vjetore të numrit të fëmijëve dhe të mësuesve;

b) regjistra të përkohshëm, si: regjistra klase;

c) rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit.

5. Institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit do të hapet kopshti i fshatit Homçan, të monitorojë veprimtarinë mësimdhënëse të këtij institucioni arsimor parauniversitar publik, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe Bashkia Pogradec.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

**URDHËR****Nr. 442, datë 4.11.2020****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR VEPRIMTARINË E KËSHILLIT
KOMBËTAR TË MUZEVE DHE
SEKRETARISË TEKNIKE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si dhe të vendimit nr. 788, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, kompetencat, mënyrën e funksionimit e të shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Muzeve”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Muzeve dhe Sekretarisë Teknike”, sipas tekstit bashkëlidhur.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Këshillit Kombëtar i Muzeve dhe të gjitha organet dhe institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore për zbatimin e kësaj rregulloreje.

3. Ngarkohet Sekretaria Teknike e Këshillit Kombëtar të Muzeve për komunikimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS**Elva Margariti****RREGULLORE
PËR VEPRIMTARINË E KËSHILLIT
KOMBËTAR TË MUZEVE
DHE SEKRETARISË TEKNIKE****Neni 1****Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave që zbatohen për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Muzeve (në vijim “KKM”), sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” (në vijim “ligji nr. 27/2018”), si dhe vendimit nr. 788, datë 26.12.2018 të Këshillit të

Ministrave, “Për përbërjen, kompetencat, mënyrën e funksionimit e të shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Muzeve”.

Neni 2**Objekti**

1. Objekt i kësaj rregulloreje është veprimtaria e KKM-së dhe e Sekretarisë Teknike.

2. Kjo rregullore përcakton:

a) rregullat dhe procedurën e funksionimit të KKM-së;

b) të drejtat dhe detyrat e kryetarit, sekretarit dhe anëtarëve të KKM-së;

c) transparencën e punës së KKM-së;

ç) instrumentet ligjore dhe teknike për zhvillimin e duhur të veprimtarisë administrative dhe teknike të KKM-së.

Neni 3**Parimet**

Anëtarët e KKM-së, gjatë kryerjes së detyrave, udhëhiqen nga parimet e:

a) ligjshmërisë;

b) barazisë së të drejtave të personave;

c) pavarësisë;

ç) përgjegjshmërisë në marrjen e vendimeve;

d) drejtësisë dhe paanësisë;

dh) profesionalizmit, cilësisë, eficiencës dhe efektivitetit të shërbimit;

e) ruajtjes së konfidencialitetit;

ë) papranueshmërisë së konfliktit të interesit.

Neni 4**Vula e KKM-së**

KKM-ja ka vulën e vet zyrtare, e cila përmban këto të dhëna:

a) Në rrethin e parë të jashtëm shkruhet “REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MINISTRIA E KULTURËS”;

b) Në rrethin e dytë shkruhet “KËSHILLI KOMBËTAR I MUZEVE” dhe “SEKRETARIA TEKNIKE”;

c) Në qendër të vulës vendoset stema e Republikës së Shqipërisë.



Neni 5

Përbërja e KKM-së

KKM-ja përbëhet nga 11 anëtarë: nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që e kryeson dhe 10 anëtarë që emërohen prej tij.

Neni 6

Emërimi dhe mbarimi i mandatit të anëtarit të KKM-së

1. Anëtari i KKM-së emërohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në bazë të kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 788, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, kompetencat, mënyrën e funksionimit e të shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Muzeve”.

2. Anëtari i KKM-së mund të japë dorëheqjen në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim kryetarin 15 ditë përpara largimit. Anëtari ka detyrimin të përmbushë detyrat e ngarkuara deri në largimin e tij, si dhe të dorëzojë detyrën sipas procedurës përkatëse.

3. Lirimi nga detyra i anëtarit të KKM-së bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Urdhri për lirimin përmban arsyen, kohën e mbarimit të detyrës dhe/ose detyrat apo përgjegjësitë e anëtarit në dorëzimin e detyrës.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrat e kryetarit, sekretarit dhe anëtarit të KKM-së

1. Kryetari i KKM-së ka të drejta dhe detyra të veçanta, si vijon:

- a) kryeson dhe drejton mbledhjet e KKM-së;
 - b) emëron dhe liron nga detyra anëtarët e KKM-së;
 - c) miraton rendin e ditës për çështjet që do të shqyrtojnë KKM-ja;
 - ç) nënshkruan vendimet e KKM-së.
2. Sekretari i KKM-së ka të drejta dhe detyra të veçanta, si vijon:
- a) asiston kryetarin në mbledhjet e KKM-së;
 - b) propozon rendin e ditës për çështjet që do të shqyrtojnë KKM-ja;
 - ç) ka të drejtë vote për çështjet në shqyrtim;
 - d) ushtron funksionet e tij me profesionalizëm dhe me përgjegjshmëri;

dh) të shmangë dhe të njoftojë kryetarin për çdo situatë konflikti interesi që ka dijeni;

e) siglon vendimet e KKM-së;

ë) drejton Sekretarinë Teknike të KKM-së.

3. Anëtari i KKM-së ka të drejta dhe detyra të veçanta, si vijon:

a) të njihet me dosjen dhe çdo dokument tjetër që lidhet me çështjen për të cilën do të marrë vendim;

b) të shprehë lirshëm mendimin e tij;

c) të kërkojë caktimin e ekspertëve të jashtëm, kur vlerëson se çështja ka nevojë për ekspertizë më të thelluar;

ç) të shpërblehet si anëtar i KKM-së;

d) të marrë pjesë rregullisht në mbledhje;

dh) të ushtrorë funksionet e tij me profesionalizëm dhe përgjegjshmëri;

e) të ruajë konfidencialitetin për çështjet, dokumentet dhe faktet për të cilat ka marrë dijeni, për shkak të detyrës;

ë) të shmangë çdo situatë konflikti interesi;

f) të votojë;

g) të arsyetojë mendimin kundër.

Neni 8

Aplikimi

1. Kërkuesi/subjekti/institucioni aplikon pranë Sekretarisë Teknike të KKM-së nëpërmjet plotësimit/depozitimit të të gjitha të dhënave, në përputhje me formatin e kërkesës dhe të dokumentacionit shoqërues të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Sekretaria Teknike e KKM-së bën regjistrimin e kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur, në regjistrin e hyrjeve dhe hap dosjen përkatëse të çështjes.

3. Nëse kërkesa e paraqitur nuk përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e parashikuar në ligj ose në aktet nënligjore, Sekretaria Teknike njofton kërkuesin dhe i cakton atij një afat 10-ditor për plotësimin e kërkesës. Nëse kërkuesi nuk plotëson dokumentacionin brenda afatit të caktuar, e kthen dosjen “pa veprim”.

4. Nëse dokumentacioni është i plotë apo plotësohet brenda afatit të përcaktuar 10-ditor, Sekretaria Teknike vlerëson dosjen për procedim të mëtejshëm.



5. Për çdo veprim të kryer, Sekretaria Teknike raporton para drejtorit të Muzeut Historik Kombëtar (MHK).

Neni 9 Sekretaria Teknike

1. Sekretaria Teknike është një strukturë administrative e krijuar pranë MHK-së, në funksion të KKM-së, e cila administron kërkesat/aplikimet e ardhura nga aplikimet, përgatit mbledhjet e KKM-së, shpërndan materialet, mban procesverbalin e mbledhjeve, harton, protokollon, njofton dhe arkivon vendimet e KKM-së, si dhe kryen çdo veprimtari tjetër të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 27/2018.

2. Sekretaria Teknike drejtohet nga drejtori i MHK-së, i cili është edhe Sekretari i KKM-së. Në mungesë të tij detyrat ushtrohen nga një person tjetër i caktuar nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. Detyrat e Sekretarisë Teknike janë, si vijon:

- a) regjistrimi i kërkesave të paraqitura (ku përfshihet i gjithë dokumentacioni i protokolluar për secilin projekt);
- b) organizimi i mbledhjeve të KKM-së;
- c) kryerja e njoftimeve dhe shpërndarja e materialeve anëtarëve të KKM-së;
- ç) mbajtja e procesverbalit të mbledhjeve;
- d) hartimi i vendimit/relacionit, sipas vendimmarrjes së KKM-së;
- e) njoftimin e vendimit kërkuesve;
- dh) mbajtjen e regjistrat të vendimeve;
- f) mbajtjen dhe administrimin e dosjeve të KKM-së;

Neni 10 Regjistrat

1. Pranë Sekretarisë Teknike mbahen regjistrat, si vijojnë:

- a) regjistri i vendimeve të KKM-së;
- b) regjistri Kombëtar i Muzeve;
- c) regjistri i hyrjeve.

2. Regjistri i vendimeve përmban të paktën të dhënat, për:

- a) numrin e vendimit;
- b) datën e vendimit;
- c) objektin e vendimit;

ç) subjekti përfitues/aplikues;

d) datën e njoftimit.

3. Regjistri Kombëtar i Muzeve përmban të dhëna, për:

- a) emërtimi i muzeut;
- b) infrastruktura fizike;
- c) koleksionet;
- ç) burimet njerëzore;
- d) financimi;
- dh) akreditimin e muzeve.

4. Regjistrat mbahen në formë manuale dhe elektronike.

Neni 11 Administrimi i dosjes nga Sekretaria Teknike

1. Sekretaria Teknike merr në shqyrtim dosjet e përcjella, sipas radhës së paraqitjes së tyre, dhe verifikon nëse aplikimi dhe dokumentacioni i përcjellë është në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi, sipas llojit të aplikimit dhe verifikon veprimet e kryera nga nëpunësi i sportelit.

2. Nëse aplikimi përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e parashikuar në ligj Sekretaria administron, në përputhje me këtë rregullore, dosjen ia përcjell për shqyrtim të mëtejshëm KKM-së.

3. Veprimet lidhur me organizimin e mbledhjeve, njoftimet, shpërndarja e materialeve dhe vendimeve kryhen nga Sekretaria Teknike, sipas kësaj rregulloreje.

Neni 12 Caktimi dhe njoftimi i mbledhjeve

1. KKM-ja mbledhet jo më shumë se 4 herë në vit, përveç rasteve përjashtimore, të thirrura nga kryetari i saj.

2. Pas shqyrtimit të relacioneve të paraqitura nga Sekretaria Teknike, kryetari i KKM-së vendos ditën dhe orën e thirrjes së mbledhjes dhe miraton rendin e ditës. Njoftimin mbi rendin e ditës dhe relacionin e Sekretarisë Teknike u përcillet gjithë anëtarëve, jo më vonë se 5 ditë para datës së caktuar për mbledhjen. Anëtarët kanë të drejtë të propozojnë ndryshime ose shtesa në rendin e ditës përpara ditës së mbledhjes.

3. Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes u komunikohet kërkuesve/aplikuesve nga Sekretaria jo më vonë se 3 ditë para datës së caktuar për



mbledhjen. Së bashku me njoftimin sekretaria përcjell edhe rendin e ditës dhe, kur është rasti, kërkon dhe paraqitjen e dokumenteve të tjera lidhur me kërkesën.

4. Anëtarët dhe kërkuesit/aplikuesit marrin pjesë në mbledhjet e KKM-së në vendin, ditën dhe orën e përcaktuar në njoftim. Në rastin e pamundësisë për të marrë pjesë në kohën dhe vendin e caktuar, kanë detyrimin të njoftojnë paraprakisht kryetarin apo sekretarin e KKM-së mbi shkaqet e mungesës dhe mundësinë e shtyrjes së mbledhjes.

Neni 13

Zhvillimi i mbledhjeve

1. Mbledhjet e KKM-së zhvillohen gjithmonë në prani të kryetarit dhe janë të vlefshme kur në to marrin pjesë 50 + 1 për qind e anëtarëve. Në rast të mosarritjes së kuorumit të kërkuar, kryetari thërret mbledhjen pasardhëse.

2. Fillimisht kryetari verifikon prezencën e anëtarëve. Në rastin e mungesës së anëtarëve, të kërkuesit/aplikuesit ose të ekspertëve, verifikon nëse ka shkaqe të justifikuara për mosparaqitjen dhe urdhëron mbajtjen e shënimit përkatës në procesverbalin e mbledhjes. Nëse është paraqitur kërkesë me shkaqet e justifikuara, kryetari shqyrton kërkesën dhe nëse e gjen të bazuar mund të vendosë shtyrjen e mbledhjes në një ditë dhe/ose orë tjetër.

3. Në rast se nga verifikimi rezulton se nuk formohet kuorumi i nevojshëm për vendimarrje, kryetari shtyn mbledhjen, por jo më vonë se 24 orë. Në rast të mosformimit sërish të kuorumit të nevojshëm për vendimarrje, KKM-ja vendos me të paktën gjysmën e anëtarëve.

4. Mbledhja e KKM-së mund të kërkohet edhe nga 1/3 e anëtarëve, duke i drejtuar kërkesë kryetarit. Zhvillimi i mbledhjes, në këtë rast, miratohet nga kryetari dhe u njoftohet të gjithë anëtarëve.

5. Në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, çdo anëtar i KKM-së, që ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit ose ka ndonjë pengesë tjetër ligjore, ka detyrim të deklarojë konfliktin e interesit dhe të kërkojë mos përfshirjen

e tij në shqyrtimin e çështjes përkatëse në rendin e ditës, përfshirë edhe procedurën e votimit.

6. KKM-ja mund të shqyrtojë dhe të votojë vetëm për ato çështje që janë përfshirë në rendin e ditës. Në mbledhje mund të shqyrtohen çështje të tjera vetëm nëse janë të pranishëm të gjithë anëtarët të cilët miratojnë përfshirjen e çështjes në rendin e ditës.

7. Sekretaria teknike e KKM-së mban dhe procesverbalin e mbledhjes, i cili përfshin:

- a) orën, datën, vendin e mbledhjes;
- b) verifikimin e prezencës së pjesëmarrësve;
- c) çështjet e diskutuara;
- ç) formën dhe rezultatin e votimeve;
- d) çdo informacion apo dokument, objekt diskutimi;
- dh) vendimarrjen;
- e) mendimin e pakicës/mendimin kundër.

Neni 14

Vendimarrja

1. Votimi në KKM është i hapur dhe të gjithë anëtarët duhet të votojnë. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm Abstenimi nuk lejohet, me përjashtim të rastit kur anëtari ka pengesë ligjore ose konflikt interesi në çështjen për të cilën do të merret vendim. Anëtarët që votojnë kundër duhet të argumentojnë me shkrim mendimin e tyre.

2. Kryetari i KKM-së voton i fundit. Në rastet kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

3. Vendimet e KKM-së nënshkruhen nga kryetari dhe siglohen nga sekretari i KKM-së, ndërsa projektet firmosen vetëm nga sekretari i KKM-së. Format i vendimeve paraqitet si aneks bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

4. Vendimi i KKM-së zbardhet nga Sekretaria Teknike në bazë të procesverbalit, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit.

5. Një projekt quhet i miratuar, kur me shumicë votash vendoset pranimi i tij pa pasur nevojë për rregullime, përmirësime apo ndryshime. Në rastin kur KKM-ja vendos se një projekt ka nevojë për rregullime, përmirësime apo ndryshime, projekti nuk konsiderohet i miratuar. Në këtë rast procedohet me shtyrje të vendimarrjes brenda 60 ditëve dhe plotësimin me propozimet dhe/ose kërkesat e lëna nga KKM-ja. Procedura e



rishqyrtimit, për plotësimet apo ndryshimet, do të jetë e njëjtë.

6. Vendimi i njoftohet subjektit të interesuar jo më vonë se 3 ditë nga data e marrjes së tij, sipas rregullave të njoftimit të akteve administrative në bazë të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 15

Shqyrtimi i çështjeve me procedurë të përshpejtuar

Në raste të jashtëzakonshme të fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura apo për çështje të një rëndësie të veçantë të interesit publik, kur rrezikohet dëmtimi i pasurive kulturore, KKM-ja merr vendim me procedurë të përshpejtuar brenda 15 ditëve. Në këtë rast, vendimi firmoset nga kryetari dhe të gjithë anëtarët.

Neni 16

Ekspertët e jashtëm

Gjatë ushtrimit të funksioneve të saj vendimmarrëse, KKM-ja mund të thërrasë, rast pas

rasti, ekspertë të jashtëm kur vlerëson që është e nevojshme, për shkak të natyrës së veçantë apo teknike të çështjes, ose të kërkojë dokumente shtesë nga kërkuesit. Ekspertët japin opinionin e tyre verbalisht ose me shkrim, sipas kërkesave dhe/ose detyrave të përcaktuara nga KKM-ja dhe nuk kanë të drejtë vote. Nëse për paraqitjen e ekspertëve ose depozitimin e dokumente të tjera është e nevojshme caktimi i një seance tjetër, KKM-ja cakton një datë tjetër për paraqitjen e ekspertit, dëgjimin e kërkuesve ose paraqitjen e dokumenteve të tjera shtesë.

Neni 17

Dispozitat e fundit

1. Çdo urdhër, udhëzim apo rregullore që është në kundërshtim me këtë rregullore shfuqizohet.

2. Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të KKM-së dhe miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 392 lekë